



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.86

11 qershor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9921 datë 26.5.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit “Mbikalmi i Durrësit dhe nyja rrugore e Vorës” 3773
Ligj nr.9922 datë 26.5.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për taksimin e automjeteve rrugore në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve”..... 3785
Ligj nr.9923 datë 29.5.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës për lehtësimin e lëshimit të vizave” 3789
Ligj nr.9924 datë 29.5.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar” 3797
Dekret nr.5756 datë 10.6.2008	Për dhënie grade madhore 3807
Dekret nr.5757 datë 10.6.2008	Për dhënie grade madhore 3808
Dekret nr.5758 datë 10.6.2008	Për dhënie grade madhore 3808
Dekret nr.5759 datë 10.6.2008	Për dhënie grade madhore 3809

LIGJ
Nr.9921, datë 26.5.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE FONDIT KUVAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “MBIKALIMI I DURRËSIT DHE NYJA RRUGORE E VORËS””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e projektit “Mbikalimi i Durrësit dhe nyja rrugore e Vorës””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5750, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

ORIGINALI: ARABISHT
NUMRI I HUASË: 766

MARRËVESHJE HUAJE

MBIKALIMI I DURRËSIT DHE PROJEKTI I MBIKALIMIT TË VORËS NË RRUGËN DURRËS- VORË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUVAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB
DATË 31.3.2008

Marrëveshje e datës 31.3.2008 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si Huamarrës), e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave si palë e parë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (në vijim referuar si Fondi) si palë e dytë.

Ndërsa Huamarrësi i ka kërkuar Fondit që të asistohet në financimin e mbikalimit të Durrësit dhe projektit të mbikalimit të Vorës në rrugën Durrës-Vorë, të përshkruar në programin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe (në vijim referuar si projekti), përgjegjësia për zhvillimin e projektit të sipërpërmendur i besohet Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (DPR) në Ministrinë e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit;

ndërsa qëllimi i Fondit është të ndihmojë vendet në zhvillim, arabe apo të tjera, në zhvillimin e ekonomive të tyre dhe t’iu ofrojë atyre hua të nevojshme për ekzekutimin e projekteve dhe programeve të tyre të zhvillimit;

ndërsa Fondi është i bindur për rëndësinë dhe dobishmërinë e projektit në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

ndërsa Fondi ka rënë dakord sa më sipër për t’i dhënë Huamarrësit një hua në bazë të kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje,

tashmë, si pasojë, palët bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Huaja, interesi dhe detyrimet e tjera, shlyerja, vendi i pagesës

Seksioni 1.01 Fondi bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, në kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje ose të referuara në të, një shumë të barasvlefshme me gjashtë milionë dinarë kuvajtianë (K.D. 6 000 000).

Seksioni 1.02 Huamarrësi do të paguajë interesat me një normë prej dy për qind (2.0%) në vit të shumës së principalit të huasë, të tërhequr dhe të papaguar herë pas here. Interesat do të rriten nga datat përkatëse në të cilat do të tërhiqen sumat.

Seksioni 1.03 Një detyrim shtesë prej një gjysmë për qind (1/2 të 1%) në vit të shumave të tërhequra të huasë dhe të papaguar herë pas here do të paguhet për të mbuluar shpenzimet administrative dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.04 Detyrimi i pagueshëm për detyrime të veçanta të parevokueshme që mund të dalin nga Fondi, me kërkesë të Huamarrësit sipas seksionit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë në normën e gjysmë për qind (1/2 të 1%) në vit mbi shumën e principalit të ndonjë detyrimi të tillë të veçantë të parevokueshëm dhe të papaguar kohë pas kohe.

Seksioni 1.05 Interesi dhe detyrime të tjera do të llogariten në bazë të vitit me 360 ditë, të dymbëdhjetë muajve me 30 ditë për një periudhë prej më pak se kohëzgjatja e gjysmës së plotë të vitit.

Seksioni 1.06 Huamarrësi do të shlyejë principalin e huasë në pajtim me programin e shlyerjes së interesit dhe principalit të huasë, të parashtruar në programin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.07 Interesi dhe detyrime të tjera do të paguhen çdo gjashtë muaj në 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

Seksioni 1.08 Huamarrësi do të ketë të drejtën, pas pagesës së të gjitha interesave të shtuar dhe të të gjithë detyrimeve të tjera dhe për një njoftim në një periudhë prej jo më pak se 45 ditësh të Fondit, të paguajë para kohe maturimin: (a) të gjithë shumën e principalit të huasë në kohën kur nuk janë paguar ose (b) të gjithën e shumës së kapitalit të ndonjë ose më shumë maturimeve, me kusht që në datën e një parapagese të tillë nuk do të ketë të lënë pezull ndonjë pjesë të maturimit të huasë pas parapagesës së pjesës përkatëse.

Seksioni 1.09 Principali dhe interesi dhe detyrime të tjera të huasë do të paguhen në Kuvajt ose në vende të tjera, sipas kërkesës së arsyeshme të Fondit.

Neni 2

Dispozitat për monedhën

Seksioni 2.01 Të gjitha llogaritë e transaksioneve financiare të bëra sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha sumat si më poshtë do të jenë të pagueshme në dinarë kuvajtianë.

Seksioni 2.02 Fondi do të blejë, sipas kërkesës dhe duke vepruar si një agent i Huamarrësit, monedhat që mund të kërkohen për pagesën e kostos së mallrave që duhen financuar nga huaja sipas kësaj Marrëveshjeje, ose për rimbursimin e këtyre kostove në monedhën në të cilën është shkaktuar aktualisht. Shuma e cila do të çmohet të jetë tërhequr nga huaja, në një rast të tillë do të jetë e barabartë me shumën në dinarë kuvajtianë që do të nevojiten për blerjen e shumës përkatëse të monedhës së huaj.

Seksioni 2.03 Kur të jetë bërë shlyerja e principalit ose pagesa e interesit dhe detyrimeve të tjera mbi huanë, Fondi, sipas kërkesës dhe duke vepruar si agent i Huamarrësit, mund të blejë shumën e dinarëve kuvajtianë që nevojitet për pagesa dhe shlyerje të tilla, sipas rastit, përkundrejt pagesës nga Huamarrësi të shumës së kërkuar për këtë blerje në monedhë ose monedha, siç mund të jetë e pranueshme kohë pas kohe nga Fondi.

Çdo pagesë për Fondin e kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të çmohet të jetë bërë përveç kohës dhe masës që dinarët kuvajtianë janë marrë aktualisht nga Fondi.

Seksioni 2.04 Kurdo që të jetë e nevojshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje për të përcaktuar vlerën e një monedhe krahasuar me tjetrën, një vlerë e tillë do të vendoset në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i të ardhurave që rrjedhin nga huaja

Seksioni 3.01 Huamarrësi do të ketë të drejtën të tërheqë nga shumat e huasë të shpenzuara ose të parashikuara për t'u shpenzuar për projektin në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Përveç rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, asnjë shumë nuk do të tërhiqet nga huaja në llogari të shpenzimeve të bëra më parë se 1.3.2008, ose për të financuar kostot lokale të mallrave të prodhuara në territoret e Huamarrësit.

Seksioni 3.02 Me kërkesë të Huamarrësit dhe sipas termave dhe kushteve të rëna dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, Fondi mund të hyjë në angazhime të veçanta me shkrim për të paguar shuma për Huamarrësin ose të tjerë përsa i përket kostove të mallrave që duhen financuar sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht ndonjë pezullimi apo anulimi pasues.

Seksioni 3.03 Kur Huamarrësi të dëshirojë të tërheqë ndonjë shumë nga huaja ose kur t'i kërkojë Fondit të hyjë në një angazhim të veçantë sipas seksionit 3.02, Huamarrësi do t'i dërgojë Fondit një aplikim me shkrim në një formë dhe me përmbajtje të deklarimeve, marrëveshjeve ose dokumenteve të tjera që Fondi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Aplikimet për tërheqje, me dokumentacionin e nevojshëm siç parashikohet në vijim në këtë nen, do të bëhen në mënyrë të menjëhershme në lidhje me shpenzimet e këtij projekti, përveç rasteve kur Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe.

Seksioni 3.04 Huamarrësi do t'i japë Fondit të gjitha dokumentet ose të dhëna të tjera në mbështetje të aplikimit për tërheqje sipas kërkesave të arsyeshme të Fondit, qoftë përpara apo pas momentit kur Fondi ka lejuar tërheqjen e kërkuar në aplikim.

Seksioni 3.05 Çdo aplikim për tërheqje dhe dokumentet shoqëruese, si dhe të dhëna të tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur Fondin se Huamarrësi është i autorizuar të tërheqë nga huaja shumën për të cilën ka aplikuar dhe që shuma që do të tërhiqet nga huaja do të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Seksioni 3.06 Huamarrësi do të përdorë të ardhurat që rrjedhin nga huaja vetëm për financimin e kostove të arsyeshme të mallrave të kërkuara për zhvillimin e projektit, të përshkruara në programin 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat specifike që duhen financuar nga të ardhurat që rrjedhin nga huaja dhe metodat dhe procedurat për prokurimin e këtyre mallrave do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, duke iu nënshtruar ndryshimeve nga marrëveshje të mëtejshme midis tyre.

Seksioni 3.07 Huamarrësi do të arsyetojë që të gjitha mallrat e financuara nga të ardhurat që rrjedhin nga huaja, do të përdoren ekskluzivisht për zhvillimin e projektit.

Seksioni 3.08 Pagesa nga Fondi, i shumëve të cilat Huamarrësi ka të drejtë t'i tërheqë nga huaja do të bëhet kundrejt ose me urdhër të Huamarrësit.

Seksioni 3.09 E drejta e Huamarrësit të bëjë tërheqje nga huaja do të përfundojë në 31.12.2011 ose në një datë tjetër siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Neni 4

Marrëveshje të veçanta

Seksioni 4.01 Huamarrësi do të marrë masat në mënyrë të kënaqshme për Fondin, që të vërë në dispozicion shumën e huasë për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve "DPR" përmes Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit apo ndonjë pasues të drejtorisë së sipërpërmendur, i pranueshëm për Fondin, përmes rrugës së alokimit buxhetor, me terma dhe kushte, të cilat duhet të jenë kurdoherë të kënaqshme për Fondin.

Seksioni 4.02 a) Huamarrësi do të zhvillojë projektin ose do të bëjë që ai të zhvillohet me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në pajtim me projektimin dhe praktikat administrative dhe financiare të qëndrueshme.

b) Sa më sipër, Huamarrësi do të sigurohet që përgjegjësia për zbatimin e projektit do t'i autorizohet një njësie zbatimi të projektit nën strukturën e DPR. Njësia e lartpërmendur do të pajiset me personel, burime dhe funksione të pranueshme për Fondin, për të bërë të mundur që të kryejë detyrat e tij, duke përfshirë ndër të tjera, prokurimin e punimeve, mallrave dhe shërbimeve dhe të bashkërendojë dhe të mbikëqyrë mbarëvajtjen e projektit. Njësia do të jetë funksionale përpara prillit 2008, ose në një datë tjetër të pranueshme për Fondin.

Seksioni 4.03 Në zhvillimin e projektit, Huamarrësi do të punësojë ose do të mundësojë që të punësohen konsulentë të projektimit të pranueshëm dhe sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Fondin.

Seksioni 4.04 Dhënia e kontratave për ekzekutimin e projektit, të cilat do të financohen nga Huaja, si dhe ndryshimi dhe përfundimi, nëse lind nevoja, i këtyre kontratave do t'i nënshtrohet miratimit nga Fondi.

Seksioni 4.05 Huamarrësi do të bëjë ose do të mundësojë që të vihen në dispozicion menjëherë sipas nevojës, të gjitha shumat që do të kërkojnë për zhvillimin e këtij projekti, dhe të gjitha këto shuma duhet të vihen në dispozicion sipas kushteve të pranueshme për Fondin.

Seksioni 4.06 Huamarrësi do t'i japë Fondit menjëherë pas përgatitjes së tyre, studimet dhe planet dhe specifikimet e projektit, programet e zbatimit dhe çdo modifikim thelbësor material të bërë më pas në të, në detajet që Fondi here pas here mund të kërkojë.

Seksioni 4.07 Huamarrësi do të ndërmarrë ose do të bëjë që të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për projektimin, zbatimin dhe operimin e projektit, për të eliminuar, lehtësuar ose kompensuar ndonjë ndikim negativ që projekti mund të ketë në mjedis.

Seksioni 4.08 Huamarrësi do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të gjithë tokën ose të drejtat për të përkjet tokës që është e nevojshme për zbatimin e projektit. Një garanci e tillë do të bëhet sipas ligjeve të zbatueshme dhe në bazë kohore, në pajtim me programin e zbatimit të projektit.

Seksioni 4.09 Huamarrësi do të mbajë ose do të mundësojë që të mbahen të dhënat e mjaftueshme për të identifikuar mallrat e financuara nga të ardhurat që rrjedhin nga huaja, për të zbuluar përdorimin e tyre në projekt, për të pasqyruar ecurinë e projektit (duke përfshirë koston e tij) dhe për të pasqyruar, në pajtim me praktikën e qëndrueshme të llogarive, operimin dhe situatën financiare të agjencisë që po zhvillon projektin, do të lejojë të gjitha mundësitë e arsyeshme të përfaqësuesve të akredituar të Fondit që të bëjnë vizita për qëllime që lidhen me huanë dhe të inspektojnë projektin, mallrat dhe çdo të dhënë dhe dokumente relevante, si dhe do t'i japë Fondit çdo informacion të tillë, që Fondi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të përkjet shpenzimit të të ardhurave që rrjedhin nga huaja, të projektit, mallrave, veprimeve dhe gjendjes financiare të agjencisë ose autoritetit që po zhvillon projektin.

Seksioni 4.10 Huamarrësi do të operojë dhe do të mirëmbajë projektin ose do të bëjë që të operohet dhe të mirëmbahet, si dhe të operojë dhe mirëmbajë struktura dhe punë dhe lehtësira të tjera jo të përfshira në projekt, por të nevojshme për veprimin efikas dhe të përshtatshëm të tij, në pajtim me projektimin dhe praktikën financiare dhe administrative të qëndrueshme. Huamarrësi do të sigurojë që burime të mjaftueshme do të alokohen për këtë qëllim dhe në përgjithësi për mirëmbajtjen e rrjetit të rrugëve kombëtare.

Seksioni 4.11 Huamarrësi do të ndërmarrë masat e nevojshme për të vëzhguar dhe mbikëqyrur rrugët e përfshira në projekt, si dhe rrjetin e autostradës, që të sigurojë se ngarkesat e boshteve të mjeteve të transportit nuk do të tejkalojnë kufijtë e pajtueshëm me projektimin e rrugëve të tilla.

Seksioni 4.12 Huamarrësi do të sigurojë që ndërtimi i mbikalimit në km 1+000 të ndërkalimit të Durrësit do të bashkërendohet me programin e ndërtimit të projektit dhe do të zbatohet më parë ose në fund të ndërtimit të projektit.

Seksioni 4.13 Huamarrësi dhe Fondi do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimet e huasë do të përmbushen. Për këtë qëllim, Huamarrësi do t'i japë Fondit që nga data e kësaj Marrëveshjeje raporte mujore mbi zbatimin e projektit dhe mbi gjendjen e përgjithshme të huasë, si dhe informacione të tjera që Fondi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Huamarrësi dhe Fondi mundet që kohë pas kohe të shkëmbejnë pikëpamje përmes përfaqësuesve të tyre për të përkjet çështjeve që lidhen me qëllimet e huasë dhe mirëmbajtjen e shërbimit të saj. Huamarrësi do të informojë menjëherë Fondin për çdo gjendje që ndërhyrë ose kërcënon për të ndërhyrë në përmbushjen e qëllimeve të huasë (duke përfshirë rritjen thelbësore në koston e projektit) ose në mirëmbajtjen e shërbimit të saj.

Seksioni 4.14 Është në qëllimin e dyanshëm të Huamarrësit dhe të Fondit që asnjë borxh i jashtëm të mos ketë përparësi mbi huanë nëpërmjet pengesave për garanci të krijuara në asetet shtetërore. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që, përveç rasteve kur Fondi bie dakord ndryshe,

nëse një pengesë e tillë garancie krijohet mbi ndonjë nga asetet e Huamarrësit si një garanci për borxhin e jashtëm, një pengesë e tillë do të sigurojë *ipso facto* në mënyrë të barabartë dhe pa ndonjë kosto nga Fondi, pagesën e shumës së principalit dhe të interesit dhe detyrimeve të tjera mbi huanë dhe që në krijimin e një pengese të tillë garancie, do të shprehet në lidhje me të; duke siguruar gjithsesi që parashikimet e mëparshme të këtij seksioni nuk do të zbatohen për:

i) çdo pengesë si garanci pagese të krijuar mbi pronën, në kohën e blerjes, vetëm si një garanci për pagesën e çmimit të kësaj prone;

ii) çdo pengesë si garanci pagese mbi mallrat tregtare për të siguruar një borxh të maturuar prej jo më shumë se një viti pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht dhe për t'u paguar nga të ardhurat e shitjes së këtyre mallrave tregtare; ose

iii) çdo pengesë si garanci pagese që vjen në rrugë të zakonshme nga transaksionet bankare dhe që sigurojnë një borxh të maturuar jo më shumë se një vit pas datës së tij.

Termi "Asetet e Huamarrësit" në kuptimin e këtij seksioni përfshin asetet e Huamarrësit ose të kujt do prej nënndarjeve të tij politike ose të çdo enti të zotëruar ose të kontrolluar nga Huamarrësi ose nga nënndarje të tilla politike, duke përfshirë Bankën Qendrore të Huamarrësit ose çdo institucion tjetër që kryen funksionet e një Banke Qendrore. Termi pengesë si garanci pagese përfshin hipotekat, garancitë, detyrimet dhe prioritetet e çdo lloji.

Seksioni 4.15 Principali dhe interesi mbi huanë dhe të gjitha detyrimet e tjera do të paguhën pa ulje dhe pa taksa që mund të jenë në fuqi sipas ligjeve të Huamarrësit ose të ligjeve në fuqi në territoret e tij, në kohën e tanishme ose që do të jenë në fuqi në të ardhmen.

Seksioni 4.16 Kjo Marrëveshje do të çlirohet nga çdo lloj takse, tatimi, tarife dhe gjobe apo detyrime të tjera të këtij lloji të parashikuara në ligjet e Huamarrësit ose në fuqi në territoret e tij, në kohën e tanishme ose në të ardhmen, mbi/ose në lidhje me zbatimin, lëshimin, dërgimin ose regjistrimin prej saj dhe Huamarrësi do të paguajë ose do të mundësojë që të paguhën të gjitha llojet e taksave, tatimeve, tarifave dhe gjobave apo detyrime të tjera të këtij lloji të parashikuara në ligjet e çdo vendi apo vendeve (përveç atyre të shtetit të Kuvajtit) në monedhat e të cilave huaja mund të shlyhet ose në ligjet në fuqi në këto territore të këtyre vendeve.

Seksioni 4.17 Principali dhe interesi dhe detyrimet e tjera mbi huanë do të paguhën pa të gjithë kufizimet, duke përfshirë kufizimet e kursit të këmbimit të parashikuara në ligjet e Huamarrësit ose ligjet në fuqi në territoret e tij.

Seksioni 4.18 Huamarrësi merr përsipër për qëllim të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së projektit, që do t'i ngarkohet "DPR" ose një agjencie tjetër të tillë që mund të jetë e pranueshme nga Fondi. Një drejtori apo agjenci e tillë do të funksionojë në çdo rast sipas rregullave dhe rregulloreve në favor të realizimit të objektivave të projektit në mënyrë të pranueshme për Fondin dhe duke pasur kompetenca menaxhimi dhe administrimi sa të jetë e nevojshme për zhvillimin dhe operimin e kujdesshëm dhe efikas të projektit.

Huamarrësi do të informojë Fondin për çdo veprim të propozuar që do të cenonte natyrën ose përbërjen e departamentit, agjencisë, institucionit ose kompanisë që zhvillon apo operon projektin dhe do t'i japë Fondit të gjithë mundësitë e arsyeshme përpara marrjes së këtij veprimi, për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin për sa i përket kësaj.

Seksioni 4.19 Huamarrësi do të sigurojë ose do të mundësojë që të sigurohen me siguries të përgjegjshëm të gjitha mallrat e financuara nga të ardhurat që rrjedhin nga huaja. Këto sigurime do të mbulojnë rreziqet detare, të transitit dhe rreziqe të tjera incidentesh të blerjes dhe të importimit të mallrave në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimin e tyre në vendin e projektit, dhe do të jetë për shumën të tilla të pajtueshme me praktikën tregtare të qëndrueshme. Sigurime të tilla do të jenë të pagueshme në monedhën në të cilën kostoja e mallrave të siguruara sipas saj do të jetë e pagueshme ose në monedhë të konvertueshme pa detyrime.

Huamarrësi do të nxjerrë dhe mirëmbajë ose do të mundësojë të nxirren dhe të mirëmbahen me siguries të përgjegjshëm, sigurime ndaj rreziqeve që lidhen me projektin në shumën të tilla të pajtueshme me praktikën tregtare të qëndrueshme.

Seksioni 4.20 Huamarrësi do të ndërmarrë ose do të mundësojë të ndërmerrin të gjitha veprimet që do të jenë të nevojshme nga ana e tij për të zbatuar projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose nuk do të lejojë të ndërmerrin asnjë veprim që mund të pengojë ose ndërhyjë në ekzekutimin dhe operimin e projektit ose në përmbushjen e ndonjë prej parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.21 Të gjitha dokumentet, arkivat, korrespondencat dhe materialet e tjera të

ngjashme të Fondit do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje konfidenciale. Huamarrësi do t'i japë imunitet të plotë Fondit nga censurimi dhe inspektimi i publikimeve.

Seksioni 4.22 Të gjitha asetet e Fondit dhe të ardhurat do të çlirohen nga shtetëzimi, konfiskimi dhe sekuestrimi.

Neni 5 Anulimi dhe pezullimi

Seksioni 5.01 Huamarrësi, duke njoftuar Fondin, mund të anulojë çdo shumë të huasë, të cilën Huamarrësi nuk e ka tërhequr përpara dhënies së një njoftimi të tillë, përveç rastit që Huamarrësi nuk mund të anulojë asnjë shumë të huasë për të cilën Fondi do të ketë hyrë në një angazhim të veçantë sipas seksionit 3.02. të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Nëse ndonjë nga rastet e mëposhtme do të ketë ndodhur dhe do jetë duke ndodhur, Fondi, duke njoftuar Huamarrësin, pezullon tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja:

a) Një mosplotësim pagese do të ketë ndodhur në pagesën e principalit ose të interesit ose të ndonjë pagese tjetër të kërkuar nga kjo Marrëveshje ose të ndonjë marrëveshje tjetër huaje midis Huamarrësit dhe Fondit;

b) Një mosplotësim pagese do të ketë ndodhur në përmbushjen e ndonjë marrëveshjeje ose angazhimi tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) Fondi do të ketë pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje sipas çdo lloji marrëveshjeje midis Huamarrësit dhe Fondit për arsye të mosplotësimit të pagesës nga ana e Huamarrësit;

d) Një situatë e jashtëzakonshme do të ketë lindur, e cila do të bëjë të pamundur që Huamarrësi të jetë i aftë të kryejë të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo ngjarje që ndodh pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe më parë se data e hyrjes në fuqi, e cila do t'i jepte mundësinë Fondit të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje, nëse kjo Marrëveshje është efektive në kohën kur një ngjarje e tillë ndodh, do t'i japë të drejtë Fondit të pezullojë tërheqjet sipas huasë pikërisht sikur të kishte ndodhur pas datës së hyrjes në fuqi.

E drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje sipas huasë do të vazhdojë të jetë e pezulluar tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa ngjarja ose ngjarjet që shkaktuan pezullimin do të pushojnë së ekzistuari ose derisa Fondi të ketë njoftuar Huamarrësin që e drejta për të kryer tërheqje është rivendosur; gjithsesi, me kusht që në rast të një njoftimi të tillë të rivendosjes, e drejta për të kryer tërheqje do të rivendoset vetëm në atë shkallë dhe duke iu nënshtruar kushteve të specifikuar në një njoftim të tillë. Një njoftim i tillë nuk do të cenojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet ndihmës të Fondit përsa i përket ndonjë ngjarjeje tjetër pasuese të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 5.03 Nëse një ngjarje e përshkruar në paragrafin (a) të seksionit 5.02. ndodh dhe vazhdon të ndodhë për një periudhë prej tridhjetë ditësh pas njoftimit të dhënë për këtë Fondit nga Huamarrësi, ose ndonjë nga ngjarjet e përshkruara në paragrafët (b), (c) dhe (d) të seksionit 5.02 do të ndodhin dhe vazhdojnë për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit të dhënë për këtë Fondit nga Huamarrësi, atëherë në çdo kohë vijuese përgjatë vazhdimit të ngjarjes, Fondi, sipas mundësive të tij, mund të deklarojë që principal i huasë të jetë e gatshme dhe e pagueshme menjëherë, dhe sipas një deklarate të tillë kjo shumë do të bëhet e gatshme dhe e pagueshme menjëherë, pavarësisht çdo gjëje në kundërshtim me të në këtë Marrëveshje.

Seksioni 5.04 Nëse (a) e drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja do të jetë pezulluar për çdo lloj shume për një periudhë në vazhdimësi prej tridhjetë ditësh, ose (b) në datën e specifikuar në seksionin 3.09 si datë mbyllëse, një shumë e huasë do të mbetet e patërhequr, Fondi, duke njoftuar Huamarrësin, mund të përfundojë të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje përsa i përket një shume të tillë. Pas dhënies së një njoftimi të tillë kjo shumë e huasë do të anulohet.

Seksioni 5.05 Asnjë anulim ose pezullim nga Fondi nuk do të aplikohet në shumat që janë subjekt i angazhimeve të veçanta në të cilat Fondi ka hyrë sipas seksioni 3.02, përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht në një angazhim të tillë.

Seksioni 5.06 Përveç rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, çdo anulim do të zbatohet *pro rata* për kështet e veçanta të shumës kryesore të huasë të maturuar pas datës së një anulimi të tillë.

Seksioni 5.07 Pavarësisht çdo anulimi apo pezullimi, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë përveç sa është parashikuar specifikisht në këtë nen.

Neni 6

Zbatueshmëria e kësaj Marrëveshjeje, mosarritja e ushtrimit të të drejtave, arbitrazhi

Seksioni 6.01 Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në pajtim me kushtet e vendosura pavarësisht ndonjë ligji lokal në kundërshtim me të. As Huamarrësi dhe as Fondi nuk do të kenë të drejtën, pavarësisht çdo lloj rrethane, të ngrenë ndonjë pretendim që ndonjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje është jo i vlefshëm dhe jo i zbatueshëm për asnjë arsye.

Seksioni 6.02 Asnjë vonesë gjatë ushtrimit apo përjashtimit nga ushtrimi, të një të drejte, pushteti apo kompensimi që i shtohet çdo pale të kësaj Marrëveshjeje për çdo mospagesë nuk do të dëmtojë një të drejtë të tillë, pushtet apo kompensim, sikundërse asnjë veprim i këtyre palëve në lidhje me ndonjë mospagesë apo ndonjë pranim në heshtje i ndonjë mospagese, nuk do të prekë apo dëmtojë çdo lloj të drejte, pushteti apo kompensimi të këtyre palëve në lidhje me çdo mospagesë tjetër apo vijuese.

Seksioni 6.03 Çdo lloj debate ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje si dhe çdo lloj pretendimi i njëres palë kundërshtues, që rrjedh nga kjo Marrëveshjeje do të vendoset me mirëkuptim mes palëve, dështimi i të cilit do të bëjë që konflikti apo pretendimi do t'i nënshtrohen gjykimit nga një gjykatë arbitrazhi siç edhe parashikohet në seksionin e mëposhtëm.

Seksioni 6.04 Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjyqtarë, të emëruar si më poshtë: një gjykatës do të caktohet nga Huamarrësi; gjyqtari i dytë do të caktohet nga Fondi; dhe gjyqtari i tretë (prej këtu e më poshtë i quajtur gjykatës) do të caktohet me marrëveshje të palëve ose, nëse nuk bien dakord, nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë të palës kundërshtare. Në rast se një nga gjyqtarët, i caktuar në përputhje me këtë seksion, do të dorëhiqet, vdesë apo bëhet i paafte të veprojë, atëherë një gjyqtar pasardhës do të caktohet në të njëjtën mënyrë siç u përshkrua më lart për caktimin e gjyqtarit paraardhës, dhe ai pasardhës do të ketë të gjithë pushtetin dhe detyrat e gjyqtarit paraardhës.

Procedurat e arbitrazhit mund të përfshihen nën këtë seksion me marrjen e njoftimit nga pala që ia ngarkon këto procedura palës tjetër. Një njoftim i tillë do të përmbajë një deklaratë, e cila përcakton natyrën e debatit apo pretendimit që do t'i nënshtrohet gjykimit, natyrën dhe shtrirjen e ndihmës së kërkuar dhe emrin e gjyqtarit i caktuar nga pala që krijon këto procedura.

Brenda tridhjetë ditëve pas dhënies së një njoftimi të tillë, pala kundërshtare do të njoftojë palën që themelon procedurat për emrin e gjyqtarit i caktuar nga kjo palë kundërshtare.

Nëse brenda 60 ditëve pas dhënies së një njoftimi të tillë që përcakton procedurat e arbitrazhit palët nuk kanë rënë dakord për një gjykatës, secila nga palët mund të kërkojë caktimin e një gjykatësi siç parashikohet në paragrafin e parë të këtij seksioni.

Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në kohën dhe vendin që do të caktojë gjykatësi. Më pas, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë ku dhe kur do të mblidhet.

Në vartësi të klauzolës së këtij seksioni dhe përveçse kur palët do të bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë të gjitha pyetjet që lidhen me kompetencat e tij si dhe do të përcaktojë procedurat e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të merren me shumicë votash. Gjykata e Arbitrazhit do t'u sigurojë të gjitha palëve një seancë të drejtë dhe do ta japë vendimin e saj me shkrim. Një vendim i tillë mund të jepet edhe në mungesë. Një vendim i firmosur nga shumica e Gjykatës së Arbitrazhit do të përbëjë vendimin e kësaj gjykate. Një kopje e firmosur e vendimit do t'i jepet çdo pale. Çdo lloj vendimi i marrë në përputhje me klauzolat e këtij seksioni do të jetë final dhe do të jetë detyrues për palët e Marrëveshjes. Çdo palë do t'i bindet dhe do të veprojë në përputhje me çdo lloj vendimi të marrë nga Gjykata e Arbitrazhit.

Palët do të bien dakord për shumën e pagesës apo tarifës së gjyqtarëve dhe personave të tjerë që mund të kërkohen për kryerjen e procedurave gjyqësore. Nëse palët nuk bien dakord për një shumë të tillë përpara se Gjykata e Arbitrazhit të mblidhet, Gjykata e Arbitrazhit do ta fiksojë vetë një shumë të tillë që do të jetë e arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat. Çdo palë do të mbulojë shpenzimet e

veta gjatë procedurave gjyqësore. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet palëve. Çdo lloj pyetje në lidhje me ndarjen e shpenzimeve të Gjykatës së Arbitrazhit ose mbi procedurën e pagesës së shpenzimeve të tilla do të përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

Gjykata e Arbitrazhit do të aplikojë parimet e përbashkëta sipas ligjeve në fuqi për Huamarrësin dhe shtetin e Kuvajtit, si dhe parimet e drejtësisë.

Seksioni 6.05 Klauzolat për gjykim të parashikuara në seksionin e mëparshëm do të zëvendësojnë çdo procedurë tjetër për përcaktimin e konflikteve ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim apo ankim që ngrihet nga njëra palë kundër tjetrës.

Seksioni 6.06 Shërbimi i çdo njoftimi apo procesi në lidhje me çdo procedim në përputhje me këtë nen mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 7.01. Palët e kësaj Marrëveshjeje mund të heqin dorë nga çdo lloj kërkesë për shërbimin e një njoftimi apo procesi të tillë.

Neni 7

Klauzola të ndryshme

Seksioni 7.01 Çdo njoftim apo kërkesë e kërkuar, apo e lejuar të jepet, ose të bëhet nën këtë Marrëveshje do të jetë me shkrim. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga seksioni 8.03, një njoftim i tillë ose kërkesë do të vlerësohet se është dhënë rregullisht kur dorëzohet dorazi, me postë elektronike, telex, telegram apo faks palës së cilës i është kërkuar apo lejuar t'i jepet, në adresën e palës siç edhe specifikohet në këtë Marrëveshje, ose edhe në një adresë tjetër të cilën pala në fjalë ia ka njoftuar palës që bën njoftimin ose kërkesën.

Seksioni 7.02 Huamarrësi do t'i sigurojë Fondit evidenca të mjaftueshme të autoritetit të personit apo personave që do të firmosin aplikimet e parashikuara në nenin 3 apo që do të marrin çdo lloj veprimi tjetër, apo do të ekzekutojnë në emër të Huamarrësit, çdo lloj dokumenti të kërkuar apo të lejuar të merret ose ekzekutohet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje si dhe firmën e vërtetuar të secilit pret këtyre personave.

Seksioni 7.03 Çfarëdo veprimi që kërkohet apo lejohet për t'u ndërmarrë dhe çfarëdo dokumentesh që kërkohen apo lejohen për t'u zbatuar, sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit, mund të ndërmerret apo zbatohet nga Ministri i Financave apo cildo person i autorizuar me shkrim prej tij. Për çfarëdo ndryshimi apo shtese të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të bihet dakord në emër të Huamarrësit me anë të një instrumenti të shkruar të zbatuar në emër të huamarrësit nga përfaqësuesi i tij i sipërpërmendur apo nga cildo person i autorizuar nga ai me shkrim; me kusht që, sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, një ndryshim apo shtesë i tillë të jetë e arsyeshme sipas rrethanave dhe të mos shtojë thelbësisht detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje. Fondi mund të pranojë zbatimin nga një përfaqësues i tillë apo person tjetër të çfarëdo instrumenti të tillë si provë përfundimtare e sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, çfarëdo ndryshim apo shtesë i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje i ardhur nga një instrument i tillë është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do t'i rrisë thelbësisht detyrimet e këtushme të Huamarrësit.

Neni 8

Data efektive, përfundimi

Seksioni 8.01 Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi deri sa Fondit t'i jenë dhënë prova të kënaqshme për Fondin se zbatimi dhe vënia në jetë e kësaj Marrëveshjeje nga ana e Huamarrësit është autorizuar në mënyrën e duhur apo është ratifikuar në të gjitha veprimet e kërkuara nga ana e qeverisë.

Seksioni 8.02 Si pjesë e evidencës për t'u pajisur me informacion në vijim të seksionit 8.01, Huamarrësi do t'i parashtojë Fondit një opinion ose opinione të autoriteteve kompetente që tregojnë që kjo Marrëveshje është autorizuar siç duhet ose ratifikuar nga, dhe zbatuar dhe shpërndarë në emër të, Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm të Huamarrësit në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 8.03 Përveç rastit kur bihet dakord ndryshe nga Fondi dhe Huamarrësi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe zbatim në datën në të cilën Fondi i nis me telegram Huamarrësit njoftimin për pranimin prej tyre të provave të kërkuara sipas seksionit 8.01.

Seksioni 8.04 Nëse të gjitha aktet e kërkuara për zbatim në vijim të seksionit 8.01 nuk do të

jenë zbatuar përpara nëntëdhjetë ditëve pas nënshkrimit të Marrëveshjes ose datë tjetër të tillë sikurse do të bihet dakord nga Fondi dhe Huamarrësi, Fondi në çdo kohë pas kësaj, me zgjedhjen e tij, mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet njoftimit të Huamarrësit. Pas dhënies së këtij njoftimi kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të mbarojnë menjëherë.

Seksioni 8.05 Nëse dhe kur e gjithë shuma kryesore e huasë dhe gjithë interesat dhe tarifa të tjera, të cilat rrjedhin nga huaja do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të mbarojnë menjëherë.

Neni 9 Përkufizime

Seksioni 9.01 Përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat në vijim do të kenë kuptimin në vijim, kudo që të përdoren në këtë Marrëveshje apo në cilindo program të saj:

1. Termi “projekt” nënkupton projektin apo projektet apo programet, për të cilat jepet huaja, siç përshkruhen në programin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç do të ndryshohet ky përshkrim kohë pas kohe me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

2. Termi “mallra” nënkupton pajisje, furnizime dhe shërbime, të cilat kërkohen për projektin. Pavarësisht nga referimi që i bëhet kostove të çdo malli, kosto të tilla do të quhen se përfshijnë koston e importimit të mallrave të tilla në territorin e Huamarrësit.

3. Termi “DPR” (në origjinal GRD) nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, e formuar brenda Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4. Termi “PIU” nënkupton njësinë e zbatimit të projektit, e cila do të vihet në dispozicion në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve “DPR”.

Adresat në vijim janë përcaktuar me hollësi për qëllimet e seksionit 7.01:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri.

Adresa alternative për telegrame, teleks dhe faks:

Telegrame	tel.	faks
.....		(355) 42-28494

Për Fondin:

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

(Kuwait Fund for Arab Economic Development)

P.O. Box 2921, Safat

Kuwait, 13030

Adresa alternative për telegrame, teleks dhe faks:

Telegrame	tel.	faks
Alsunduk	22025 alsunduk	(965)2999190
Kuwait	22613 kfaed kt	(965)2999091

Në dëshmi të kësaj, palët si më poshtë, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë arritur këtë Marrëveshje për t'u nënshkruar në emrat e tyre përkatës dhe për t'u dërguar në Tiranë, në dy kopje, secila e konsideruar si origjinale dhe të gjitha njëjloj të barasvlershme që nga dita dhe viti i shkruar së pari më lart.

Republika e Shqipërisë

Nga: _____
(Përfaqësuesi i autorizuar)

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga: _____
(Përfaqësuesi i autorizuar)

PROGRAMI 1
DISPOZITAT PËR SHLYERJET

Shuma e principalit e tërhequr nga huaja do të shlyhet në tridhjetë e dy (32) këste gjysmë-vjetore, sipas shumës dhe rendit të njëpasnjëshëm të secilës siç përcaktohet në programin bashkëngjitur. I pari nga këto këste duhet të kryhet në datën e parë në të cilën çfarëdo interesi apo tarifash të tjera mbi huanë duhet të paguhet, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së huasë, pas kalimit të një periudhe falje prej katër (4) vjetësh, duke filluar nga data në të cilën Fondi paguan, çfarëdo shume nga huaja në vijim të aplikimit të parë për tërheqje të bërë nga Huamarrësi në datën në të cilën Fondi lëshon një sipërmarrje në përputhje me seksion 3.02 të Marrëveshjes së huasë, në rast se aplikimi i parë për tërheqje kërkon një sipërmarrje të tillë, cilado të jetë më e hershme nga këto dy data. Këstet që mbeten për shlyerjen e principalit do të paguhet në mënyrë të njëpasnjëshme çdo gjashtë muaj pas datës në të cilën duhet bërë pagesa e kështit të parë.

PROGRAMI I AMORTIZIMIT

Numri rendor	Data e pagesës së detyrimit	Pagesa e principalit (e shprehur në dinarë kuvajtianë)
1	-----	187500
2	-----	187500
3	-----	187500
4	-----	187500
5	-----	187500
6	-----	187500
7	-----	187500
8	-----	187500
9	-----	187500
10	-----	187500
11	-----	187500
12	-----	187500
13	-----	187500
14	-----	187500
15	-----	187500
16	-----	187500
17	-----	187500
18	-----	187500
19	-----	187500
20	-----	187500
21	-----	187500
22	-----	187500
23	-----	187500
24	-----	187500
25	-----	187500
26	-----	187500
27	-----	187500
28	-----	187500
29	-----	187500
30	-----	187500
31	-----	187500
32	-----	187500
	Shuma	6 000 000

PROGRAMI 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është të rrisë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të rajoneve të Lindjes

Qendrore dhe Lindore të Shqipërisë, dhe të sigurojë trafik rrugor të lirshëm në segmentin Durrës–Vorë të Korridorit Durrës–Morinë, duke përmbushur kërkesën në rritje të trafikut në korridorin e lartpërmendur.

Projekti konsiston në blerjen e tokës, shërbime këshillimore dhe ndërtimin e punimeve të dheut, shtresat e trotuareve, betonimet, strukturat mbajtëse, sistem kanalesh kulluese, dhe masa sigurie për pjesët përbërëse të mëposhtme të projektit:

1. Mbikalimin e Durrësit duke përfshirë përafërsisht 5 km. 4 korsi autostradë me rrugët ndihmëse, rrethrotullime, mbikalime, nënkalime, duke përfshirë përafërsisht 4 km të rrugëve furnizuese dykalimëshe që lidhin mbikalimin në portin e Durrësit.

2. Nyja e Vorës duke përfshirë menaxhimin e trafikut 3 km rrjetin e rrugëve përafërsisht me shtrirje 2 km në autostradën Durrës–Tiranë, me rrugët ndihmëse, rrethrotullimet, mbikalimet dhe nënkalimet, dhe përmirësimin e 4 korsive ekzistuese të autostradës.

Projekti pritet të përfundojë në fund të 2010.

Faqja nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Data: 31.3.2008

Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab
(Kuwait Fund for Arab Economic Development)
P.O. Box 2921, Safat
Kuwait, 13030

Zotërinj,

Duke iu referuar Marrëveshjes së huasë lidhur me mbikalimin e Durrësit dhe nyjën lidhëse të Vorës në rrugën Durrës-Vorë, nënshkruar sot ndërmjet Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ne konfirmojmë që të ardhurat e huasë do të caktohen për financimin e materialeve dhe shërbimeve të paraqitura në listën bashkëngjitur në përqindjet dhe shumat e përmendura aty, pasi e njëjta listë mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Fondit, duke nënkuptuar që këto ndryshime nuk do të sjellin rritjen e shumës aktuale të huasë.

Është e kuptueshme që çdo tepriçë në shpërndarjen e çdo artikulli do të transferohet në fondin e shpenzimeve të paparashikuara, ndërkohë që çdo deficit në shpërndarje për çdo artikull mund të arrihet me miratimin e Fondit, nëpërmjet rishpërndarjes së fondit të shpenzimeve të paparashikuara.

Ne gjithashtu konfirmojmë që asnjë e ardhur e huasë nuk do të përdoret për pagesa taksash ose detyrime doganore të detyrueshme nga ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Përsa u përket shërbimeve këshillimore, si dhe duke iu referuar ndarjes 4.03 të kësaj Marrëveshjeje huaje, tenderi do të jetë i kufizuar për firma me kapital të përbashkët ndërmjet këshilluesve kuvajtianë dhe shqiptarë. Fondi kuvajtian do të na sigurojë në një listë të këshilltarëve kuvajtianë. Një listë e këshilltarëve të shoqërive me kapital të përbashkët do të përgatitet prej nesh dhe do t'i dërgohet Fondit për miratim. Vlerësimi i ofertave do të bazohet në të dyja kriteret, atë teknik dhe financiar, duke filluar me vlerësimin e kriterit teknik fillimisht, më pas vlerësimin financiar, ndërkohë që masa 70% e vlerës do t'i jepet vlerësimit teknik dhe 30 % vlerësimit financiar. Raporti i vlerësimit përfundimtar do t'i dërgohet Fondit për miratim. Bazuar në sa më lart kontrata do t'i akordohet atyre me pikë më të larta të të dyja vlerësimeve teknike dhe financiare që i nënshtrohen miratimit të Fondit.

Përsa i përket ndërtimit të punëve, tenderi do të kufizohet për shoqëritë me kapital të përbashkët ndërmjet kontraktorëve të Kuvajtit dhe Shqipërisë. Publikimi për parakualifikim të shoqërive me kapital të përbashkët do të publikohet në gazetën kuvajtiane dhe shqiptare. Shoqëritë me kapital të përbashkët që marrin një vlerësim teknik më shumë se 70% do të konsiderohen si të kualifikuara. Një raport parakualifikues do të përgatitet prej nesh dhe do t'i dërgohet Fondit për miratim. Më pas propozimet do të merren nga shoqëritë me kapital të përbashkët të parakualifikuara. Një raport i vlerësimit të ofertave do të përgatitet prej nesh dhe do t'ju dërgohet ju për miratim. Bazuar në sa më lart kontrata do t'i jepet ofertës më të ulët duke marrë miratimin e Fondit.

Në vijim të nënshkrimit të kontratave ne do t'ju pajisim ju me kopje të njëjta të kontratave të

tilla me qëllim mbajtjen e të dhënave tuaja dhe lëvrimin nga huaja në përputhje me këtë.

Me qëllim dhënien në kohë të kontratave për zbatimin e projektit, një program do të hartohet për fazat e ndryshme të ofertave, vlerësimin e ofertave, dhe dhënien e të gjitha kontratave kryesore dhe do të marrim të gjitha hapat e nevojshme për t'iu bashkëngjitur këtij programi dhe për t'ju pajisur ju me një kopje të saj.

Ju lutem konfirmoni pranimin tuaj për përmbajtjen e kësaj letre duke nënshkruar kopjen bashkëngjitur dhe duke na e kthyer atë pas.

Republika e Shqipërisë
Nga: _____
(Përfaqësuesi i autorizuar)

Pranuar:
Fondi Kuvajitian për
Zhvillimin Ekonomik Arab
Nga: _____
(Përfaqësuesi i autorizuar)

LISTA E MALLRAVE

Numri rendor	Artikulli	Shpërndarja e kësteve (e shprehur në dinarë kuvajtianë)	Përqindja e kostos së përgjithshme të artikullit
1	Punime të inxhinierisë civile për mbikalimin e Durrësit	3 600 000	75 %
2	Punime të inxhinierisë civile për mbikalimin e Vorës	1 550 000	75 %
3	Shërbime këshillimi	250 000	100 %
4	Shuma të palëvruara	600 000	
Shuma e përgjithshme e huasë		6 000 000 Gjashtë milionë dinarë kuvajtianë	

* Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e projektit, duke përfshirë taksat, TVSH, shpronësimet dhe interesat gjatë ndërtimit është afërsisht 7.92 milionë dinarë kuvajtianë KD. Fondi i Kuvajtit do të financojë vetëm deri në shumën 6 000 000 KD. Të gjitha kostot që mbeten do të financohen nga qeveria e Shqipërisë.

Faqja nr. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Data: 31.3.2008

Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab
(Kuwait Fund for Arab Economic Development)
P.O. Box 2921, Safat
Kuwait, 13030

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar Marrëveshjes së huasë lidhur me projektin e mbikalimit të Durrësit dhe nyjës së Vorës në rrugën Durrës–Vorë, nënshkruar sot ndërmjet Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ne konfirmojmë që jemi informuar sipas të gjitha rregullave që në përputhje me rregullat në fuqi në shtetin e Kuvajtit, përdorimi i fondeve publike në transaksione që përfshijnë një shoqëri që është subjekt përjashtimi bazuar në këto rregulla, është i ndaluar.

Për këtë qëllim ne biem dakord që procedurat e huasë së sipërpërmendur nuk do të përdoren në asnjë mënyrë për financimin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të materialeve dhe shërbimeve të siguruar nga çdo shtet, shoqëri ose agjenci që i nënshtrohet përjashtimit në përputhje me rregullat në fuqi të shtetit të Kuvajtit.

Republika e Shqipërisë

Pranuar:

Nga: _____
(Përfaqësuesi i autorizuar)

Fondi Kuvajtian për
Zhvillimin Ekonomik Arab
Nga: _____
(Përfaqësuesi i autorizuar)

LIGJ
Nr.9922, datë 26.5.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
“PËR TAKSIMIN E AUTOMJETEVE RRUGORE NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR
TË UDHËTARËVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për taksimin e automjeteve rrugore në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve”, nënshkruar në Gjenevë më 14 dhjetor 1956.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5751, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

KONVENTA
MBI TAKSIMIN E AUTOMJETEVE RRUGORE
NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE

Palët kontraktuese,
duke kërkuar të lehtësojnë zhvillimin e turizmit ndërkombëtar,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllim të kësaj Konvente:

a) Termi “automjete” nënkupton të gjitha automjetet rrugore vetëlëvizëse dhe të gjitha rimorkiot që lidhen me këto automjete, qoftë të importuara bashkë me automjetin, qoftë të importuara veçmas;

b) Termi “transport ndërkombëtar i udhëtarëve” nënkupton transportin e personave dhe bagazheve të tyre, nëse kanë, kundrejt pagesës, shpërblimit ose forme tjetër, dhe çdo lloj transporti të kryer me anë të mjeteve të transportit të udhëtarëve, që kanë më shumë se tetë vende, përveç vendit të shoferit, kur rruga e ndjekur kalon përmes të paktën një kufiri midis dy shtetesh;

c) Termi “taksa dhe tatime mbi transportin” nënkupton:

Taksat mbi xhiron dhe taksa të ngjashme, si për shembull taksa mbi vlerën e shtuar;

Tarifat për nxjerrjen e licencave të transportit ose dokumente të tjera të nevojshme;

Taksat ose taksat shtesë për t'u paguar për këtë veprim transporti, plus dhe mbi taksat e

caktuara vetëm mbi të drejtën e mbajtjes së automjetit dhe përdorimit të tij në rrugë.

Neni 2

Automjetet që regjistrohen në territorin e një prej Palëve Kontraktuese dhe që përdoren në regjimin e importit të përkohshëm gjatë kryerjes së transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese, sipas kushteve të paraqitura më poshtë, do të përjashtohen nga taksat dhe tatimet e vendosura mbi qarkullimin ose qëndrimin e automjetit në territorin e asaj Pale Kontraktuese. Ky përjashtim nuk do të zbatohet për pagesat, taksat dhe tatimet mbi konsumin ose taksat ose tatimet mbi transportin.

Neni 3

1. Ky përjashtim do të lejohet në territorin e çdo Pale Kontraktuese sa kohë që përmbushen kushtet e paraqitura në rregulloren doganore në fuqi të atij territori për pranimin e përkohshëm pa pagesën e tarifave doganore dhe taksave të importit të automjeteve të përcaktuara në nenin 2, dhe sa kohë që përmbushen kushtet e paraqitura në rregulloret në fuqi për autorizimin e këtij transporti.

2. Megjithatë, çdo Palë Kontraktuese mund të përjashtojë nga përfitimi prej këtij përjashtimi çdo automjet që ajo mund të autorizojë për përdorim transporti, kur edhe pika e nisjes, edhe ato të mbërritjes ndodhen brenda territorit të saj.

Dispozita përfundimtare

Neni 4

1. Vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe vendet e pranuar për këtë komision si palë konsultative, sipas paragrafit 8 të Termave të Referencës së komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese e Kësaj Konvente:

- a) duke e nënshkruar atë;
- b) duke e ratifikuar atë, pasi kanë nënshkruar duke iu nënshtruar ratifikimit;
- c) duke e pranuar.

2. Këto vende që marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit Ekonomik për Europën, në përputhje me paragrafin 11 të Termave të Referencës së Komisionit, mund të bëhen Palë Kontraktuese e kësaj Konvente duke e pranuar, pasi ajo ka hyrë në fuqi.

3. Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim deri më dhe përfshirë datën 18 maj 1957. Pas kësaj date, ajo do të jetë e hapur për pranim.

4. Ratifikimi ose pranimi, realizohen me anë të depozitimit të një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 5

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë nga data kur pesë vendet e paraqitura në nenin 4, paragrafi 1, e kanë nënshkruar atë pa rezervën e ratifikimit ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose pranimi.

2. Për çdo vend që e ratifikon ose e pranon, pasi pesë vende e kanë nënshkruar atë pa rezervën e ratifikimit ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose pranimi, kjo konventë do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pasi vendi i përmendur ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose pranimi.

Neni 6

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Konventë, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë muaj nga data kur Sekretari i Përgjithshëm i

Kombeve të Bashkuara ka marrë njoftimin e denoncimit.

Neni 7

Kjo Konventë do të shfuqizohet, nëse për një periudhë dymbëdhjetë mujore pas hyrjes së saj në fuqi, numri i Palëve Kontraktuese është më i vogël se pesë.

Neni 8

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente pa rezervën e ratifikimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, ose pranimi ose në çdo periudhë të mëvonshme, mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se kjo Konventë do të shtrihet te të gjitha ose çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai është përgjegjës. Konventa do të shtrihet në territorin ose territoret e përmendura në njoftim nëntëdhjetë ditë nga data kur është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm, ose, nëse atë ditë kjo Konventë nuk ka hyrë ende në fuqi, në kohën kur ajo hyn në fuqi.

2. Çdo vend që ka bërë një deklaratë sipas pikës së mësipërme, që e shtrin vlefshmërinë e kësaj Konvente në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund ta denoncojë Konventën veçmas për atë territor, në përputhje me dispozitat e nenit 6.

Neni 9

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, përsa të jetë e mundur, duhet të zgjidhet me anë të negociatave midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje, që nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të dërgohet për arbitrazh, nëse një nga Palët Kontraktuese në konflikt e kërkon këtë, dhe do t'i paraqitet me radhë një ose më shumë gjyqtarëve arbitrazhi, të zgjedhur në marrëveshje nga Palët në konflikt. Nëse, brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, Palët në konflikt nuk bien dakord për zgjedhjen e gjyqtarit të arbitrazhit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, një nga Palët Kontraktuese mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të emërojë një gjyqtar të vetëm arbitrazhi, të cilit do t'i paraqitet çështja për vendim.

3. Vendimi i gjyqtarit ose gjyqtarëve të arbitrazhit, të caktuar sipas pikës së mësipërme, do të zbatohet nga Palët Kontraktuese në konflikt.

Neni 10

1. Çdo Palë Kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimi në këtë Konventë, mund të deklarojë që nuk e konsideron veten të detyruar prej nenit 9 të Konventës, Palët e tjera Kontraktuese nuk do të jenë të detyruara ndaj nenit 9, në lidhje me çdo Palë Kontraktuese, e cila ka një rezervë të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese, e cila ka paraqitur rezervë, siç parashikohet në pikën e mësipërme, mund ta tërheqë këtë rezervë në çdo moment, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Nuk do të lejohet asnjë rezervë tjetër ndaj kësaj Konvente.

Neni 11

1. Tre vjet pasi kjo Konventë ka qendruar në fuqi, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë mbledhjen e një konference me qëllim rishikimin e Konventës, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese që kanë bërë kërkesën dhe një konferencë rishikimi do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm nëse brenda një periudhe katërmujore nga data kur Sekretari i Përgjithshëm ka bërë njoftimin, jo më pak se një e treta e Palëve Kontraktuese e lajmërojnë atë për miratimin e kërkesës nga

ana e tyre.

2. Nëse një konferencë mblidhet në përputhje me paragrafin e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm do t'i njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese dhe do t'i ftojë ato të dorëzojnë, brenda një periudhe tremujore, ato propozime që ato do të dëshironin që konferenca t'i merrte në shqyrtim. Sekretari i Përgjithshëm duhet të qarkullojë te të gjitha Palët Kontraktuese një rend dite provizor të konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve, të paktën tre muaj para datës, në të cilën do të mblidhet konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo konferencë të mbledhur, në përputhje me këtë nen të gjitha vendet e paraqitura në nenin 4, paragrafi 1, dhe vendet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 4 paragrafi 2.

Neni 12

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë Konventë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do të transmetohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'u transmetojë të gjitha Palëve Kontraktuese dhe njoftojë të gjitha vendet e tjera të referuara në nenin 4, paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar, që qarkullohet në përputhje me paragrafin e mësipërm, do të gjykohet i pranuar, nëse asnjë Palë Kontraktuese nuk shpreh ndonjë kundërshtim brenda një periudhe gjashtëmujore pas datës, kur Sekretari i Përgjithshëm ka qarkulluar amendamentin e propozuar.

3. Sekretari i Përgjithshëm, sa më shpejt që të jetë e mundur, do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese, nëse është shprehur ndonjë kundërshtim për amendamentin e propozuar. Nëse është shprehur një kundërshtim për amendamentin e propozuar, amendamenti do të gjykohet i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë fuqi ligjore. Nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese tre muaj, pas skadimit të periudhës gjashtë mujore të përcaktuar në pikën e mësipërme.

Neni 13

Përveç njoftimeve të marra parasysh në nenet 11 dhe 12, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë shtetet e paraqitura në nenin 4, paragrafi 1 dhe vendet që janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenin 4, paragrafi 2, për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet, sipas nenit 4;
- b) datat e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 5;
- c) denoncimet sipas nenit 6;
- d) shfuqizimin e kësaj Konvente, në përputhje me nenin 7;
- e) njoftimet e marra, në përputhje me nenin 8;
- f) deklaratat dhe njoftimet e marra, në përputhje me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2;
- g) hyrje në fuqi të çdo amendamenti, në përputhje me nenin 12.

Neni 14

Pas datës 18 maj 1957, kopja origjinale e kësaj Konvente do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të dërgojë kopje të certifikuara të origjinalit te secili prej vendeve të përmendura në nenin 4, pika 1 dhe 2.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më katërmëdhjetë dhjetor njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në anglisht dhe frëngjisht; të dy tekstet njëloj autentike.

LIGJ

Nr.9923, datë 29.5.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË DANIMARKËS PËR
LEHTËSIMIN E LËSHIMIT TË VIZAVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës për lehtësimin e lëshimit të vizave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5752, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË DANIMARKËS
MBI LEHTËSIMIN E LËSHIMIT TË VIZAVE**

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Mbretëria e Danimarkës, që këtu quhen Palët,

me dëshirën, që si hap i parë konkret drejt regjimit të udhëtimit pa viza, për të lehtësuar kontaktet ndërmjet njerëzve si një kusht i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të lidhjeve ekonomike, humanitare, kulturore, shkencore dhe të tjera duke lehtësuar lëshimin e vizave për qytetarët e Republikës së Shqipërisë;

duke patur parasysh që, nga data 4 gusht 2000, qytetarët e BE-së janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë për të udhëtuar në Republikën e Shqipërisë për një periudhë kohore që nuk tejkalon 90 ditë për një periudhë prej 180 ditësh ose kalimin transit në territorin e Republikës së Shqipërisë;

duke njohur që, nëse Republika e Shqipërisë do të rivendoste kërkesën për vizë për shtetasit e BE-së, të njëjtat lehtësira që jepen në bazë të kësaj marrëveshjeje për shtetasit e Republikës së Shqipërisë do të zbatoheshin automatikisht edhe për shtetasit danezë;

duke njohur që lehtësimi i vizave nuk duhet të shkaktojë migrim të paligjshëm dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurisë dhe ripranimit;

duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës për ripranimin e personave me banim pa leje;

duke u bazuar në marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi lehtësimin e lëshimit të vizave dhe në deklaratën e përbashkët për Mbretërinë e Danimarkës, bashkëlidhur,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është lehtësimi i lëshimit të vizave për një qëndrim që synohet jo më shumë se 90 ditë për një periudhë 180 ditë për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

2. Nëse Republika e Shqipërisë do të rivendoste kërkesën për vizë për shtetasit e BE-së ose kategori të tjera të qytetarëve të BE-së, të njëjtat lehtësira që u jepen në bazë të kësaj Marrëveshjeje qytetarëve të Republikës së Shqipërisë do të zbatoheshin automatikisht në bazë të reciprocitetit për shtetasit danezë.

Neni 2

Dispozitë e përgjithshme

1. Lehtësirat e vizave, të parashikuara në këtë Marrëveshjeje, zbatohen për shtetasit e Republikës së Shqipërisë në masën që ata nuk janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore të Bashkimit Europian dhe të Danimarkës, kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare.

2. Ligji i brendshëm i Republikës së Shqipërisë ose ligji i brendshëm i Mbretërisë së Danimarkës, ose e drejta e Bashkimit Europian zbatohet për çështjet që nuk janë të mbuluara nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, si refuzimi i një vize, njohja e dokumenteve të udhëtimit, provimi i mjeteve të mjaftueshme të jetesës dhe refuzimi i hyrjes dhe masat e dëbimit.

Neni 3

Përkufizim

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” është një person që ka shtetësinë shqiptare;
- b) “Shtetas i Mbretërisë së Danimarkës” është një person që ka shtetësinë daneze;
- c) “Viza” është autorizimi i lëshuar ose një vendim i marrë nga Danimarka, i tillë që kërkohet me qëllim të:
 - hyrjes për një qëndrim të synuar në Danimarkë ose në disa shtete anëtare të Shengenit për jo më shumë se 90 ditë në tërësi,
 - hyrjes për kalim transit në territorin e Danimarkës ose disa shteteve anëtare të Shengenit.
- d) “Person me banim të ligjshëm” do të thotë një shtetas i Republikës së Shqipërisë të autorizuar ose me të drejtë qëndrimi për më shumë se 90 ditë në territorin e një shteti anëtar në Shengen, ose në bazë të legjislacionit të brendshëm ose komunitar.
- e) “Shtet anëtar i Shengenit” do të thotë çdo shtet që aplikon plotësisht rregullat e Shengenit.
- f) “Zona Shengen” do të thotë zona e shteteve anëtare të Shengenit.

Neni 4

Provat shkresore në lidhje me qëllimin e udhëtimit

1. Për kategoritë e mëposhtme të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dokumentet e mëposhtme janë të mjaftueshme për të provuar qëllimin e udhëtimit në Palën tjetër:

- a) Për anëtarët e delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese zyrtare drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë në takime, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Danimarkës nga organizatat ndërqeveritare:
 - një shkresë lëshuar nga autoriteti shqiptar që konfirmon që kërkuesi është anëtar i delegacionit shqiptar që udhëton për në territorin e Danimarkës për të marrë pjesë në ngjarjet e sipërpërmendura, të shoqëruar me një kopje të ftesës zyrtare.
- b) Për biznesmenët dhe përfaqësuesit e organizatave të biznesit:
 - një kërkesë me shkrim nga një person juridik ose një shoqëri, organizatë pritëse ose një zyrë apo degë e këtij personi juridik apo shoqërie, shteti ose autoritetet lokale të Danimarkës ose komiteteve organizuese të ekspozitave tregtare dhe industriale, konferencave dhe simpoziumeve të mbajtura në territorin e Danimarkës, të miratuara nga një dhomë tregtie e Republikës së Shqipërisë.

c) Për gazetarët:

- një certifikatë ose dokument tjetër të lëshuar nga një organizatë profesionale që provon që personi i interesuar është një gazetar i kualifikuar dhe një dokument i lëshuar nga punëdhënësi i tij/saj, që deklaron se qëllimi i udhëtimit është ushtrimi i aktivitetit të gazetarisë.

d) Për personat që marrin pjesë në aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë universitetin dhe programe të tjera shkëmbimi:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse për të marrë pjesë në këto aktivitete.

e) Për përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile gjatë ndërmarrjes së udhëtimeve për qëllimet e trajnimit edukativ, seminareve, konferencave, duke përfshirë brenda kuadrit të programeve të shkëmbimit:

- një kërkesë me shkrim lëshuar nga organizata pritëse, një konfirmim që personi përfaqëson organizatën e shoqërisë civile dhe vërtetimin për themelimin e kësaj organizate nga regjistri përkatës e lëshuar nga autoriteti shtetëror në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

f) Për nxënësit, studnetët, studentët pasuniversitarë dhe mësuesit shoqërues që ndërmarrin udhëtime për qëllimin e studimit ose trajnimit arsimor, duke përfshirë në kuadrin e programeve të shkëmbimit, si dhe aktivitete të tjera në lidhje me shkollën:

- një kërkesë me shkrim ose një vërtetim regjistrimi nga universiteti, akademia, instituti, kolegji ose shkolla pritëse, ose librezja e studentit ose vërtetimi i lëndëve që do të ndiqen.

g) Për pjesëmarrësit në aktivitetet sportive ndërkombëtare dhe personat shoqërues të tyre në cilësinë profesionale:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse: autoritetet kompetente, federatat kombëtare sportive ose Komiteti Kombëtar Olimpik i Danimarkës.

h) Për pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit të organizuara nga qytetet e binjakëzuara:

- një kërkesë me shkrim të kreut të administratës/kryetarit të bashkisë së këtyre qyteve.

i) Për të afërmit e afërt – bashkëshort, fëmijë (duke përfshirë të adoptuarit), prindërit (duke përfshirë kujdestarët), prindërit e prindërve dhe fëmijët e fëmijëve – që vizitojnë qytetarët shqiptarë me banim të ligjshëm në territorin e Danimarkës:

- kërkesë me shkrim nga personi pritës.

j) Për arsye të vizitave për varrimet civile dhe ushtarake:

- një dokument zyrtar që konfirmon ekzistencën dhe ruajtjen e varrit, si dhe marrëdhënieve familjare ose të tjera ndërmjet kërkuarit dhe të varrosurit.

k) Për personat e përndjekur për motive politike gjatë regjimit komunist në Republikën e Shqipërisë:

- një vërtetim i lëshuar nga Instituti për Integrimin e Personave të Persekutuar në pajtim me nenin 3 të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, që tregon statusin e qenies së një personi të përndjekur për motive politike gjatë regjimit komunist në Republikën e Shqipërisë dhe një ftesë nga një autoritet kompetent, organizatë kombëtare ose ndërkombëtare duke përfshirë një OJF të Danimarkës ose nga një institucion evropian për pjesëmarrje në aktivitete, sipas rastit, duke përfshirë aktivitetet në lidhje me statusin e tyre.

l) Për shoferët që kryejnë shërbime transporti ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve në territorin e Danimarkës në automjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë:

- një kërkesë me shkrim nga shoqata (bashkime) kombëtare e transportuesve të Republikës së Shqipërisë që parashikon transport ndërkombëtar rrugor, që cakton qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve.

m) Për personat që udhëtojnë për turizëm:

- një vërtetim ose faturë nga një agjenci udhëtimi ose operator i turit të akredituar nga Danimarka dhe anëtarë të tjerë të Shengenit në kuadrin e një bashkëpunimi konsullor lokal që konfirmon rezervimin e një udhëtimi të organizuar.

n) Për personat që bëjnë viza për qëllime mjekësore dhe personat e nevojshëm shoqërues:

- një dokument zyrtar të institucionit mjekësor që konfirmon domosdoshmërinë e kujdesit mjekësor në këtë institucion, domosdoshmërinë e të qenit të shoqëruar, dhe prova për mjete të mjaftueshme financiare për të paguar për trajtimin mjekësor.

o) Për anëtarët e profesioneve që marrin pjesë në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare ose ngjarje të tjera të ngjashme të mbajtura në territorin e Danimarkës:

- një kërkesë me shkrim nga organizata pritëse që konfirmon që personi i interesuar do të marrë pjesë në aktivitet.

p) Për anëtarët e ekuipazhit të trenave, frigoriferëve dhe lokomotivave në trenat ndërkombëtarë, që udhëtojnë në territoret e Danimarkës:

- një kërkesë me shkrim nga shoqëria kompetente e hekurudhave të Republikës së Shqipërisë që tregon qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve.

q) Për personat që bëjnë vizita për ceremonitë e varrimeve:

- një dokument zyrtar që konfirmon faktin e vdekjes, si dhe konfirmimin e marrëdhënies familjare ose tjetër ndërmjet kërkuarit dhe të varrosurit.

r) Për përfaqësuesit e komuniteteve fetare:

- një kërkesë me shkrim nga një komunitet fetar i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që tregon qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve.

2. Kërkesa me shkrim e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban elementet e mëposhtme:

a) për personin e ftuar – emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, seksin, shtetësinë, numrin e dokumentit të identifikimit, kohën dhe qëllimin e vizitës, numrin e hyrjeve dhe, sipas rastit, emrin e bashkëshortit dhe fëmijëve që shoqërojnë personin e ftuar;

b) për personin që bën ftesën – emrin, mbiemrin dhe adresën; ose

c) për personin juridik, shoqërinë ose organizatën që bën ftesën – emrin dhe adresën e plotë dhe

- nëse kërkesa është lëshuar nga një organizatë, emrin dhe pozicionin e personit që ka nënshkruar kërkesën,

- nëse personi që bën ftesën është person juridik ose shoqëri, apo një zyrë ose degë e një personi juridik apo shoqërie të tillë të themeluar në territorin e Danimarkës, numri i regjistrimit sipas kërkesave të ligjit të brendshëm të Danimarkës.

3. Për kategoritë e personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha kategoritë e vizave lëshohen në pajtim me procedurën e thjeshtuar pa kërkuar ndonjë provë, ftesë ose vërtetim tjetër në lidhje me qëllimin e udhëtimit, të parashikuar nga legjislacioni i Danimarkës.

Neni 5

Lëshimi i vizave me shumë hyrje

1. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Danimarkës lëshojnë viza hyrjeje me një afat vlefshmërie deri në pesë vjet për kategoritë e mëposhtme të personave:

a) anëtarët e Këshillit të Ministrave, Parlamentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, nëse ata nuk janë përjashtuar nga kërkesa për vizë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, në ushtrim të detyrave të tyre, me një afat vlefshmërie të kufizuar brenda afatit të tyre të detyrës nëse është më pak se 5 vjet;

b) anëtarët e përhershëm të delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese zyrtare drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë rregullisht në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Danimarkës nga organizatat ndërqeveritare;

c) bashkëshortët dhe fëmijët (duke përfshirë të adoptuarit), që janë nën moshën 21 vjeç ose janë persona të varur, që vizitojnë shtetas shqiptarë me banim të ligjshëm në territorin e Danimarkës brenda afatit të vlefshmërisë të kufizuar në kohëzgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit të vendbanimit të tyre të ligjshëm.

2. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Danimarkës lëshojnë viza me shumë hyrje brenda afatit të vlefshmërisë deri në një vit për kategoritë e mëposhtme të personave, me kusht që gjatë vitit të kaluar të kenë marrë të paktën një vizë, ta kenë përdorur atë në pajtim me ligjet për hyrjen dhe qëndrimin në shtetin e vizituar dhe ka edhe arsye të tjera për të kërkuar viza me shumë hyrje:

a) anëtarët e delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese zyrtare drejtuar Republikës së

Shqipërisë, marrin pjesë rregullisht në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në aktivitetet e organizuara në territorin e Danimarkës nga organizatat ndërqeveritare;

b) biznesmenët dhe përfaqësuesit e organizatave të biznesit që udhëtojnë rregullisht për në Danimarkë;

c) personat që marrin pjesë në aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë programet universitare dhe të tjera të shkëmbimit, që udhëtojnë rregullisht për në Danimarkë;

d) pjesëmarrësit në aktivitetet ndërkombëtare të sportit dhe personat që i shoqërojnë në cilësinë zyrtare;

e) gazetarët;

f) pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit të organizuara nga qytetet e binjakëzuara;

g) shoferët që kryejnë shërbime transporti ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve për në territorin e Danimarkës në automjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

h) personat që duhet të bëjnë rregullisht vizita për arsye mjekësore dhe personat e nevojshëm shoqëruar;

i) anëtarët e ekipazheve të trenave, frigoriferëve dhe lokomotivës në trenat ndërkombëtarë, që udhëtojnë për në territorin e Danimarkës;

j) studentët dhe studentët pasuniversitarë që udhëtojnë rregullisht për qëllimet e studimit ose trajnimit arsimor, duke përfshirë në kuadrin e programeve të shkëmbimit;

k) përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Republikën e Shqipërisë, që udhëtojnë rregullisht për në Danimarkë;

l) përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që udhëtojnë rregullisht për në Danimarkë për qëllimet e trajnimit arsimor, seminare, konferenca, duke përfshirë në kuadrin e programeve të shkëmbimit;

m) anëtarët e profesioneve që marrin pjesë në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare dhe aktivitete të tjera të ngjashme që udhëtojnë rregullisht për në Danimarkë;

3. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Danimarkës lëshojnë viza me shumë hyrje me një afat vlefshmërie prej minimalisht 2 vjet dhe maksimalisht 5 vjet për kategoritë e personave të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që gjatë viteve të kaluara ata t'i kenë përdorur vizat njëvjeçare me shumë hyrje në pajtim me ligjet për hyrjen dhe qëndrimin të shtetit të vizituar dhe shkaqet për kërkimin e vizës me shumë hyrje të jenë ende të vlefshme.

4. Periudha e plotë e qëndrimit për personat e përmendur në paragrafët 1 deri 3 të këtij neni nuk i kalojnë 90 ditë për një periudhë 180 ditë në territorin e Danimarkës dhe të ndonjë shteti tjetër anëtar i Shengenit.

Neni 6

Tarfia për përpunimin e kërkesave për viza

1. Tarifa për përpunimin e kërkesave për vizë të shtetasve të Republikës së Shqipërisë është 35 euro.

Shuma e sipërpërmendur mund të rishikohet në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 13(4).

Nëse Republika e Shqipërisë do të rivendoste kërkesën për vizë për qytetarët e BE-së, tarifa e vizës, që duhet të caktohet nga Republika e Shqipërisë, nuk do të jetë më e lartë se 35 euro ose shuma e rënë dakord, nëse tarifa rishikohet në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 13(4).

2. Tarifat për përpunimin e kërkesës për vizë nuk paguhet për kategoritë e mëposhtme të personave:

a. të afërmit – bashkëshortët, fëmijët (duke përfshirë të adoptuarit), prindërit (duke përfshirë kujdestarët), prindërit e prindërve dhe fëmijët e fëmijëve të shtetasve shqiptarë me banim të ligjshëm në territorin e Danimarkës;

b) anëtarët e delegacioneve zyrtare që, në bazë të një ftese drejtuar Republikës së Shqipërisë, marrin pjesë në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe aktivitetet e organizuara në territorin e Danimarkës nga organizatat ndërqeveritare;

c) anëtarët e Këshillit të Ministrave, Parlamentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë,

nëse nuk janë të përjashtuar nga kërkesat për vizë nga kjo Marrëveshje;

d) nxënësit, studentët, studentët pasuniversitarë dhe mësuesit që i shoqërojnë, që kryejnë udhëtime për qëllime të studimit ose trajnimit arsimor;

e) fëmijët nën 6 vjeç;

f) personat me aftësi të kufizuar dhe personat që i shoqërojnë ata, nëse është e nevojshme;

g) personat që kanë paraqitur dokumente që provojnë domosdoshmërinë e udhëtimit të tyre për qëllime humanitare, duke përfshirë marrjen urgjent të trajtimit mjekësor dhe personi që shoqëron këtë person, ose për të ndjekur një varrim të një të afërmi, ose për të vizituar një të afërm shumë të sëmurë;

h) pjesëmarrësit në aktivitetet sportive ndërkombëtare dhe personat që i shoqërojnë ata në cilësinë zyrtare;

i) personat që marrin pjesë në aktivitetet shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë programe të tjera universitare të shkëmbimit;

j) pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit, të organizuara nga qytetet e binjakëzuara;

k) personat e përndjekur për motive politike gjatë regjimit komunist;

l) pensionistët;

m) përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që udhëtojnë për të marrë pjesë në takime, seminare, programe shkëmbimi ose kurse trajnimi;

n) gazetarët;

o) përfaqësuesit e komuniteteve fetare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

p) shoferët që kryejnë shërbime transporti ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve për në territorin e Danimarkës në automjete të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

q) anëtarët e ekuipazheve të trenave, frigoriferëve ose lokomotivave në trenat ndërkombëtarë, që udhëtojnë për në territorin e Danimarkës;

r) anëtarët e profesioneve që marrin pjesë në ekspozita ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, seminare ose aktivitete të tjera të ngjashme që organizohen në territorin e Danimarkës.

Neni 7

Kohëzgjatja e procedurave për përpunimin e kërkesave për vizë

1. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Danimarkës e marrin vendimin për kërkesën për lëshimin e një vize brenda 10 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës dhe dokumenteve që kërkohen për marrjen e vizës.

2. Afati kohor për marrjen e një vendimi për një kërkesë për vizë mund të zgjatet deri në 30 ditë kalendarike në raste të veçanta, kryesisht kur kërkohet shqyrtim i mëtejshëm i kërkesës.

3. Afati kohor për marrjen e vendimit për një kërkesë për vizë mund të pakësohet në 3 ditë pune ose më pak në raste urgjente.

Neni 8

Largimi në rastin e dokumenteve të humbura ose të vjedhura

Shtetasit e Danimarkës dhe të Republikës së Shqipërisë që kanë humbur dokumentet e tyre të identifikimit ose të cilëve u janë vjedhur gjatë qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të Danimarkës, mund të largohen nga ky territor mbi bazën e dokumenteve të vlefshme që japin të drejtën e kalimit të kufirit, të lëshuara nga misionet diplomatike ose zyrat konsullore të Danimarkës ose të Republikës së Shqipërisë pa vizë ose ndonjë autorizim tjetër.

Neni 9

Zgjatja e vizës në rrethana të veçanta

Shtetasve të Republikës së Shqipërisë që nuk e kanë mundësinë të largohen nga territori i Danimarkës në momentin e caktuar në vizën e tyre për shkak të forcës madhore, u zgjatet afati i vizës pa pagesë në pajtim me legjislacionin e zbatuar nga shteti pritës për periudhën e kërkuar për kthimin e tyre në shtetin e vendbanimit të tyre.

Neni 10
Pasaportat diplomatike

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, zotërues të pasaportave të vlefshme diplomatike, mund të hyjnë, largohen ose kalojnë transit në territorin e Danimarkës pa vizë.

2. Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të qëndrojnë në territoret e Danimarkës dhe në ndonjë nga shtetet anëtare të Shengenit për një periudhë që nuk kalon 90 ditë për një periudhë prej 180 ditësh.

Neni 11
Vlefshmëria territoriale e vizave

Në pajtim me rregullat dhe rregulloret e brendshme në lidhje me sigurinë kombëtare të Danimarkës dhe në pajtim me rregullat e BE-së për vizat me vlefshmëri territoriale të kufizuar, shtetasit e Republikës së Shqipërisë kanë të drejtë të udhëtojnë brenda territorit të shteteve anëtare të Shengenit njësoj si shtetasit e Bashkimit Europian.

Neni 12
Monitorimi i marrëveshjes

Përfaqësuesit e Palëve do të takohen sa herë është e nevojshme me kërkesë të njëres nga Palët për të diskutuar mbi zbatimin e kësaj marrëveshjeje, dhe nëse vlerësohet e nevojshme propozojnë ndryshime për këtë marrëveshje, veçanërisht në lidhje me ndryshimet e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian mbi lehtësimin e lëshimit të vizave.

Neni 13
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje ratifikohet ose miratohet nga Palët në pajtim me procedurat e tyre përkatëse dhe hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e përmendura me sipër janë përfunduar.

2. Në rast të moszbatimit të paragrafit të 1 të nenit të mësipërm, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian mbi lehtësimin e vizave” dhe “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës për ripranimin e personave”, në rast se kjo datë do të jetë më vonë se data e hyrjes në fuqi, sipas paragrafit të parë të nenit 13.

3. Kjo marrëveshje përfundohet për një periudhë kohore të përcaktuar, nëse nuk priset në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni.

4. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi pasi Palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

5. Secila Palë mund ta pezullojë tërësisht ose pjesërisht këtë marrëveshje për shkaqe të rendit publik, mbrojtjes së sigurisë kombëtare ose mbrojtjes e shëndetit publik. Vendimi për pezullimin i njoftohet Palës tjetër jo më vonë se 48 orë para hyrjes së tij në fuqi. Pala që ka pezulluar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje informon Palën tjetër menjëherë sapo të mos ekzistojnë shkaqet e pezullimit.

6. Secila Palë mund ta prishë këtë marrëveshje duke i bërë Palës tjetër një njoftim me shkrim. Kjo Marrëveshje pushon së qeni në fuqi 90 ditë pas datës së një njoftimi të tillë.

Bërë në Tiranë, më 24 prill 2008, në dy kopje në gjuhën shqipe, daneze dhe angleze, duke qenë secili prej këtyre teksteve njëlloj autentik. Në rast keqinterpretimeve, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Nr.9924, datë 29.5.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË DANIMARKËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Danimarkës për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5753, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË DANIMARKËS
PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR**

Palët e larta kontraktuese,
Republika e Shqipërisë, në vijim e përmendur si “Shqipëria”,
dhe Mbretëria e Danimarkës, në vijim e përmendur si “Danimarka”,
të vendosura për të forcuar bashkëpunimin e tyre me qëllimin për të luftuar emigracionin e paligjshëm në mënyrë më efektive;

duke dëshiruar të përcaktojnë, me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi bazën e reciprocitetit, procedura të shpejta dhe të efektshme për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave të cilët nuk përmbushin ose nuk i përmbushin më tej, kushtet për të hyrë, për të qëndruar ose për të banuar në territoret e Shqipërisë ose të Danimarkës, dhe për të lehtësuar kalimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi;

duke theksuar që kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shqipërisë dhe Danimarkës, të cilat burojnë nga e Drejta Ndërkombëtare dhe, në veçanti, nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nga Konventa e 28 korrikut 1951 dhe protokollin i 31 janarit 1967 për Statusin e Refugjatëve, dhe nga instrumentet ndërkombëtare për ekstradimin;

duke u bazuar në marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, e cila hyri në fuqi më 1 maj 2006 dhe deklaratën e përbashkët për sa i përket Danimarkës, gjendur në aneksin e asaj marrëveshjeje,

kanë rënë dakord për sa vijon:

**Neni 1
Përkufizime**

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

- a) “Shtetas i Shqipërisë” nënkupton çdo person që ka shtetësinë shqiptare;
- b) “Shtetas i Danimarkës” nënkupton çdo person që ka shtetësinë daneze;
- c) “Shtetas i një vendi të tretë” nënkupton çdo person që ka shtetësi të ndryshme nga ajo daneze ose shqiptare.
- d) “Person pa shtetësi” nënkupton çdo person që nuk ka asnjë shtetësi.
- e) “Leje qëndrimi” nënkupton një leje të çdo lloji të lëshuar nga Danimarka ose nga Shqipëria që i jep të drejtën një personi të qëndrojë në territorin e saj. Ky përkufizim nuk përfshin lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e saj në lidhje me shqyrtimin e një aplikimi për azil ose të një aplikimi për leje qëndrimi.
- f) “Vizë” nënkupton një autorizim të lëshuar apo një vendim të marrë nga Danimarka ose Shqipëria, i cili kërkohet për të hyrë ose për të kaluar transit në territorin e tij. Ky përkufizim nuk përfshin vizën e transitit aeroportual.

SEKSIONI I DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA SHQIPËRIA

Neni 2

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Shqipëria do të ripranojë, me kërkesën e Danimarkës dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë, ose nuk plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Danimarkës, me kusht që të provohet, ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata janë shtetas të Shqipërisë.

Kjo dispozitë do të zbatohet edhe për personat të cilëve u është hequr, ose që kanë hequr dorë nga, shtetësia shqiptare që nga hyrja në territorin e Danimarkës, me përjashtim kur këtyre personave u është premtuar dhënia e shtetësisë së plotë nga Danimarka.

2. Shqipëria, sipas nevojës dhe pa vonesë, do të pajisë personin për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumentin e udhëtimit që kërkohet për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë të paktën gjashtëmujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, do të pranohet përdorimi i dokumentit standard të udhëtimit të Bashkimit Europian për qëllime të dëbimit (1).

Neni 3

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Shqipëria do të ripranojë, me kërkesën e Danimarkës dhe pa formalitete të mëtejshme veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Danimarkës, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata persona:

- a) kanë, ose në kohën kur kanë hyrë kishin vizë ose leje qëndrimi të lëshuar nga Shqipëria; ose
- b) kanë hyrë në territorin e Danimarkës, pasi kanë qëndruar në, ose kanë kaluar transit nëpër territorin e Shqipërisë.

2. Detyrimi për ripranim i parashikuar në paragrafin 1 nuk do të zbatohet nëse:

- a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Shqipërisë; ose

- b) Danimarka i ka lëshuar shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose leje qëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj përveç rastit kur

- ai person zotëron një vizë ose leje qëndrimi lëshuar nga Shqipëria, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Danimarka është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara.

3. Shqipëria, sipas nevojës dhe pa vonesë, do ta pajisë personin për ripranimin e të cilit është rënë dakord me dokumentin e udhëtimit që kërkohet për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore nëse për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Shqipëria brenda 14 ditëve kalendarike nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i dokumentit standard të udhëtimit të Bashkimit Europian për qëllime të dëbimit.

SEKSIONI II DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA DANIMARKA

Neni 4

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Danimarka do të ripranojë, me kërkesë të Shqipërisë dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë, ose që nuk plotësojnë më tej kushtet për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Shqipërisë, me kusht që të provohet, ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata janë shtetas të Danimarkës.

Kjo dispozitë do të zbatohet edhe për personat të cilëve u është hequr, ose kanë hequr dorë nga shtetësia e Danimarkës që nga hyrja në territorin e Shqipërisë, me përjashtim kur këtyre personave u është premtuar dhënia e shtetësisë nga Shqipëria.

2. Danimarka, sipas nevojës dhe pa vonesë, do ta pajisë personin për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumentin e udhëtimit që kërkohet për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Danimarka, brenda 14 ditëve kalendarike, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Danimarka, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i certifikatës shqiptare për qëllime të dëbimit (2).

Neni 5

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Danimarka do të ripranojë, me kërkesë të Shqipërisë dhe pa formalitete të mëtejshme veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të cilët nuk plotësojnë, ose nuk plotësojnë më tej kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta se këta persona:

a) kanë, ose në kohën kur kanë hyrë, kanë pasur vizë ose leje qëndrimi të lëshuar nga Danimarka; ose

b) kanë hyrë në territorin e Shqipërisë pasi kanë qëndruar në ose kanë kaluar tranzit nëpër territorin e Danimarkës.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk do të zbatohet nëse:

a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Danimarkës; ose

b) Shqipëria i ka dhënë shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose leje qëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj përveç rastit kur:

- ai person zotëron një vizë ose lejeqëndrimi lëshuar nga Danimarka, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Shqipëria është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara.

3. Danimarka, sipas nevojës dhe pa vonesë, do ta pajisë personin për ripranimin e të cilit është rënë dakord me dokumentin e udhëtimit që kërkohet për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Danimarka brenda 14 ditëve kalendarike do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është e nevojshme, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Danimarka brenda 14 ditëve kalendarike nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i certifikatës shqiptare për qëllime të dëbimit.

SEKSIONI III PROCEDURA E RIPRANIMIT

Neni 6 **Parimi**

1. Sipas paragrafit 2, çdo transferim i një personi që do të ripranohet mbi bazën e njërit prej detyrimeve që përmbajnë nenet 2 deri 5 kërkon paraqitjen e një kërkesë për ripranim tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

2. Kërkesa për ripranim mund të zëvendësohet me një komunikim me shkrim pranë autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme përpara kthimit të personit në fjalë me kusht që personi që do të ripranohet zotëron një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe, aty ku është e zbatueshme, një vizë ose leje qëndrimi të vlefshme të shtetit të kërkuar.

Neni 7 **Kërkesa për ripranim**

1. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) të dhënat personale të personit që do të ripranohet (p.sh. emri, mbiemri, data e lindjes, dhe – aty ku është e mundur – vendi i lindjes, emri i babait, emri i nënës dhe vendbanimi i fundit);

b) përshkrim i mënyrave me anë të të cilave do të sigurohen provat e qarta për shtetësinë, transitin, kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, si dhe hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm.

2. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a) një deklaratë ku tregohet që personi që do të transferohet mund të ketë nevojë për ndihmë apo kujdes, me kusht që personi në fjalë të ketë shprehur pranimin e tij për këtë deklaratë;

b) çdo masë tjetër mbrojtjeje apo sigurie e cila mund të jetë e nevojshme për rastin e veçantë të transferimit.

3. Një formular i përbashkët që do të përdoret për kërkesat për ripranim është bashkëngjitur si aneksi 5 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8 **Mjetet e provës në lidhje me shtetësinë**

1. Prova për shtetësinë sipas neneve 2 (1) dhe 4 (1) mund të jepet veçanërisht nëpërmjet çdonjërit prej dokumenteve të renditura në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, Shqipëria dhe Danimarka do të njohin reciprokisht shtetësinë pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm. Prova për shtetësinë nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

2. Provat prima facie (e qarta) për shtetësinë sipas neneve 2 (1) dhe 4 (1) mund të jepen veçanërisht nëpërmjet dokumenteve të renditura në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e tyre e vlefshmërisë ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tillë, Shqipëria dhe

Danimarka do të pranojnë përcaktimin e shtetësisë, me përjashtim të rastit kur ato mund të vërtetojnë të kundërtën. Provat e qarta në lidhje me shtetësinë nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

3. Nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e renditura në anekset 1 ose 2, përfaqësitë kompetente diplomatike dhe konsullore të Danimarkës ose Shqipërisë do të marrin masat, me paraqitjen e një kërkesë, për të intervistuar pa vonesë personin që do të ripranohet me qëllim që të përcaktojnë shtetësinë e tij/saj.

Neni 9

Mjetet e provës në lidhje me shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi

1. Prova e kushteve për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi përcaktuar në nenin 3 (1) dhe nenin 5 (1) do të jepet veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të listuara në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje; ajo nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Çdo provë e tillë njihet reciprokisht nga Shqipëria dhe Danimarka pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm.

2. Provat prima facie (e qarta) për kushtet e ripranimit të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi, përcaktuar në nenet 3 (10) dhe 5 (1) jepen veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të shënuara në aneksin 4 të kësaj Marrëveshjeje; ato nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Kur paraqiten të tilla prova prima facie (të qarta), Shqipëria dhe Danimarka vlerësojnë përcaktimin e kushteve, përveç rastit kur mund të vërtetojnë të kundërtën.

3. Paligjshmëria e hyrjes, qëndrimit apo banimit do të përcaktohet me anën e dokumenteve të udhëtimit, të personit në fjalë, në të cilat mungojnë viza apo leja e qëndrimit në territorin e shtetit kërkuar. Një deklaratë e shtetit kërkuar që personi në fjalë është gjetur pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit, vizë apo leje qëndrimi paraqitet si provë e qartë për hyrjen, qëndrimin ose banimin e paligjshëm.

Neni 10

Afatet kohore

1. Kërkesa për ripranim duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe maksimale njëvjeçare nga koha kur autoriteti kompetent i shtetit kërkuar merr dijeni që një shtetas i një vendi të tretë apo një person pa shtetësi nuk plotëson, ose nuk i plotëson më tej, kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin. Kur ka pengesa ligjore ose faktike që kërkesa të paraqitet në kohë, afati kohor, me kërkesë të shtetit kërkuar, do të shtyhet, por vetëm derisa pengesa të mos ekzistojë më.

2. Një kërkesë për ripranim duhet t'i kthehet përgjigje pa vonesë të panevojshme, dhe në çdo rast brenda një periudhe maksimale prej 14 ditësh kalendarike; për mospranimin e një kërkesë për ripranim do të jepen arsye. Afati kohor fillon nga data e marrjes së kërkesës për ripranim. Nëse brenda këtij afati kohor nuk ka përgjigje, do të konsiderohet se është rënë dakord për transferimin e personit.

3. Pasi është pranuar kërkesa apo, kur është e nevojshme, pas mbarimit të periudhës prej 14 ditësh kalendarike, personi në fjalë transferohet pa vonesë dhe, e shumta, brenda tre muajsh. Mbi bazën e kërkesës së shtetit kërkuar ky afat kohor mund të zgjatet sa koha që duhet për të kaluar pengesat ligjore apo praktike.

Neni 11

Modalitetet e transferimit dhe mënyrat e transportimit

1. Para kthimit të një personi, autoritetet kompetente të Danimarkës dhe Shqipërisë do të bien në ujdi që më parë me shkrim në lidhje me datën e transferimit, vendin e hyrjes, shoqërimin e mundshëm dhe të dhëna të tjera që kanë lidhje me transferimin.

2. Nuk ndalohet asnjë mjet transporti, qoftë nga ajri, toka apo deti. Kthimi në rrugë ajrore nuk do të kufizohet në përdorimin e shoqërive të transportit të Danimarkës ose Shqipërisë dhe mund të kryhet duke përdorur avionë linje apo charter. Në rastin e kthimeve të shoqëruara, këta shoqërues nuk

kufizohen vetëm në persona të autorizuar të shtetit kërkues, me kusht që të jenë persona të autorizuar nga Danimarka ose nga Shqipëria.

Neni 12 **Ripranimi i gabuar**

Shqipëria do të marrë mbrapsht pa vonesë çdo person të ripranuar nga Danimarka, dhe Danimarka do të marrë mbrapsht pa vonesë çdo person të ripranuar nga Shqipëria, nëse vërtetohet, brenda një periudhe tremujore pas transferimit të personit në fjalë, që nuk plotësohen kërkesat e vendosura në nenet 2 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje. Në këto raste, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe Danimarkës do të shkëmbejnë gjithashtu të gjithë informacionin e disponueshëm që ka të bëjë me identitetin aktual, shtetësinë ose itinerarin e transitimit të personit që do të kthehet.

SEKSIONI IV OPERACIONET TRANSIT

Neni 13 **Parimet**

1. Shqipëria dhe Danimarka do të kufizonin kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi në raste kur këta persona nuk mund të kthehen direkt në shtetin e destinacionit.

2. Shqipëria do të lejojë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi, nëse Danimarka e kërkon një gjë të tillë, dhe Danimarka do të autorizojë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi, nëse Shqipëria e kërkon një gjë të tillë, nëse sigurohet udhëtimi i mëtejshëm transit në shtete të tjera të mundshme të transitit dhe nëse sigurohet ripranimi nga shteti i destinacionit.

3. Transiti mund të refuzohet nga Shqipëria ose Danimarka:

a) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi rrezikon realisht të bëhet subjekt i torturave apo i trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor apo poshtërues, i dënimit me vdekje ose i përndjekjes për shkak të racës, fesë, kombësisë, pjesëmarrjes në një grup shoqëror apo një bindjeje politike të veçantë, në shtetin për ku është drejtuar apo në një shtet tjetër ku do të kalojë transit; ose

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do t'i nënshtrohet ndjekjes ose sanksioneve penale në shtetin e kërkuar ose në një shtet tjetër ku do të kalojë transit; ose

c) për arsye të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të tjera të shtetit të kërkuar.

4. Shqipëria ose Danimarka mund të anulojnë çdo leje të dhënë, nëse më vonë dalin në dritë rrethanat e përmendura në paragrafin 3, të cilat bëhen pengesë për operacionet e transitit ose nëse udhëtimi i mëtejshëm në shtete të mundshme të transitit ose nuk sigurohet më ripranimi nga ana e shtetit të destinacionit. Në këtë rast shteti kërkues e merr sërish shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, sipas nevojës dhe pa vonesë.

Neni 14 **Procedura e transitit**

1. Një kërkesë për operacionet e transitit duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar me shkrim dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e transitit (me rrugë ajrore, tokësore apo detare), shtetet e tjera të mundshme për transit dhe destinacioni përfundimtar;

b) të dhënat e veçanta të personit në fjalë (p.sh. emri, mbiemri, emri i vajzërisë, emra të tjerë që përdor ose pseudonime, data e lindjes, seksi dhe – aty ku është e mundur - vendi i lindjes, kombësia, gjuha, lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit);

- c) vendi i parashikuar i hyrjes, koha e transferimit dhe përdorimi i mundshëm i shoqëruesve;
d) një deklaratë që sipas mendimit të shtetit kërkuar përmbushen kushtet lidhur me nenin 13 (2) dhe që nuk ka arsye për mospranim sipas nenit 13 (3).

Një formular i përbashkët për t'u përdorur për kërkesat për kalim transit është bashkëngjitur si aneksi 6 i kësaj Marrëveshjeje.

2. Shteti i kërkuar do të njoftojë, brenda pesë ditëve kalendarike dhe me shkrim, shtetin kërkuar për pranimin, duke konfirmuar vendin e hyrjes dhe kohën e parashikuar të pranimit, ose do ta njoftojë atë për mospranimin e kërkesës dhe për arsyet e këtij mospranimi.

3. Nëse operacionet e transitit kryhen në rrugë ajrore, personi që ripranohet dhe shoqëruesit e mundshëm shmangen nga detyrimi për të marrë vizë transiti aeroportuale.

4. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar do të ndihmojnë në operacionet e transitit, pas konsultimeve reciproke, në veçanti nëpërmjet mbikëqyrjes së personave në fjalë dhe dhënies së mjeteve të përshtatshme për këtë qëllim.

SEKSIONI V KOSTOT

Neni 15

Kostot e transportit dhe transitit

Pa cenuar të drejtën e autoriteteve kompetente për të rimbursuar kostot, lidhur me riparimin, të shkaktuara nga ana e personit që do të ripranohet apo nga palë të treta, të gjitha kostot e transportit në lidhje me ripranimin dhe operacionet e transitit në përputhje me këtë Marrëveshje deri në kufirin e shtetit të destinacionit përfundimtar do të përballohen nga ana e shtetit kërkuar.

SEKSIONI VI MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLAUZOLA E MOSNDIKIMIT

Neni 16

Mbrojtja e të dhënave

Komunikimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm nëse është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Danimarkës ose Shqipërisë sipas rastit. Përpunimi dhe trajtimi i të dhënave personale në ndonjë rast të veçantë do t'u nënshtrohet ligjeve të brendshme të Shqipërisë dhe kur autoriteti kontrollues është autoritet kompetent i Danimarkës, do t'i nënshtrohet dispozitave të direktivës 95/46/EC (3) dhe të legjislacionit kombëtar. Gjithashtu do të zbatohen edhe parimet e mëposhtme:

- a) të dhënat personale duhet të transmetohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b) të dhënat personale duhet të mbliken për qëllim specifik, të qartë dhe të ligjshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe nuk duhet të përpunohen më tej nga autoriteti dërgues as edhe nga autoriteti marrës në një mënyrë që nuk përputhet me këtë qëllim;
- c) të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, përkatëse dhe të mos e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe/ose komunikuar në veçanti, të dhënat personale që komunikohen mund të kenë të bëjnë vetëm me sa vijon:
 - të dhënat e veçanta të personit që do të transferohet (p.sh. emri, mbiemri, emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime, seksi, gjendja civile, data dhe vendi i lindjes, kombësia aktuale dhe e mëparshme);
 - pasaportën, kartën e identitetit ose dëshminë e aftësisë për drejtim mjeti (numri, periudha e vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti që e ka lëshuar, vendi ku është lëshuar);
 - ndalesat dhe itineraret;
 - informacione të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet ose për të shqyrtuar kërkesat e ripranimit në përputhje me këtë Marrëveshje;
- d) të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, aty ku është e mundur, të përditësuara.
- e) të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave për jo më shumë sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur

ose për të cilin përpunohen më tej.

f) Autoriteti komunikues dhe autoriteti marrës i të dhënave do të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të bërë saktësimin, eliminimin ose bllokimin e duhur të të dhënave personale në rastin kur komunikimi i tyre nuk përputhet me dispozitat e këtij neni, në mënyrë të veçantë nëse ato të dhëna nuk janë të përshtatshme, nuk janë përkatëse, janë të pasakta ose e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë komunikuar, Kjo përfshin njoftimin e çdo korrigjimi, zhdukjeje apo bllokimi nga Pala tjetër.

g) Mbi bazën e kërkesës, autoriteti marrës i të dhënave do të informojë autoritetin komunikues, mbi përdorimin e të dhënave të komunikuar dhe për rezultatet e përfuara prej tyre.

h) Të dhënat personale mund të komunikohen vetëm autoriteteve kompetente.

Komunikimi i mëtejshëm për organizma të tjerë kërkon pranimin paraprak të autoritetit komunikues.

i) Autoriteti dërgues dhe autoriteti marrës i të dhënave janë të detyruara të mbajnë procesverbal me shkrim për komunikimin dhe marrjen e të dhënave personale.

Neni 17

Klauzola e mosndikimit

1. Kjo Marrëveshje do të bëhet pa cenuar të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shqipërisë dhe Danimarkës që burojnë nga e drejta ndërkombëtare, dhe veçanërisht nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa e 28 korrikut 1951 dhe protokollin e 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve, dhe instrumentet ndërkombëtare mbi ekstradimin.

2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndalon kthimin e një personi sipas marrëveshjeve të tjera formale apo informale.

SEKSIONI VII

REALIZIMI DHE ZBATIMI

Neni 18

Grupi i përbashkët i ekspertëve

1. Palët kontraktuese do të japin njëra-tjetrës asistencë të ndërsjellë në zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim ato do të krijojnë një Grup të Përbashkët Ekspertësh (në vijim i quajtur “Grupi i Ekspertëve”) i cili do të ketë, në veçanti, detyrën:

a) të kontrollojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) të vendosë për masat e nevojshme për realizimin për zbatimin e njëjtë të kësaj Marrëveshjeje;

c) të ketë shkëmbime të rregullta informacioni mbi protokollet e zbatimit të hartuar nga Danimarka dhe Shqipëria në përputhje me nenin 19;

d) të vendosë për amendamentet në anekset e kësaj Marrëveshjeje;

e) të rekomandojë amendamentet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Vendimet e Grupit të Ekspertëve janë të detyrueshme për Palët Kontraktuese.

3. Grupi i ekspertëve do të përbëhet nga ekspertë nga Danimarka dhe Shqipëria;

4. Grupi i ekspertëve do të mblidhet sa herë që është e nevojshme me kërkesën e njëres nga Palët Kontraktuese.

5. Grupi i ekspertëve do të përcaktojë rregullat e tij procedurale.

Neni 19

Protokolli i zbatimit

1. Danimarka dhe Shqipëria mund të hartojnë protokoll zbatimi, i cili do të përcaktojë rregullat për:

a) caktimin e autoriteteve kompetente, pikave të kalimit kufitar dhe shkëmbimin e pikave të kontaktit;

b) kushtet për kthimet e shoqëruara, përfshi transitin e shoqëruar të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi;

c) mjete dhe dokumente shtesë veç atyre të listuara në anekset 1 deri 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të ratifikohet apo miratohet nga Palët Kontraktuese në përputhje me procedurat e tyre përkatëse.

2. Sipas paragrafit 3, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës kur Palët Kontraktuese njoftojnë njëra – tjetrën që janë përfunduar procedurat e përcaktuara në paragrafin e parë. Nëse kjo datë është më e hershme se data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërmjet Mbretërisë së Danimarkës dhe Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e dhënies së vizave, kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi para datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së vizave.

3. Nenet 3 dhe 5 të kësaj Marrëveshje do të hyjnë në fuqi 2 vjet pas datës së cituar në paragrafin 2.

4. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohë të pakufizuar.

5. Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar zyrtarisht Palën tjetër Kontraktuese. Kjo Marrëveshje do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

Neni 21

Anekset

Anekset nga 1 deri në 6 janë një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 24 prill 2008, në dy kopje në gjuhën shqipe, daneze dhe angleze. Në rast të diferencave në interpretim do të ketë përparësi teksti në anglisht.

1. Rekomandimi i këshillit i datës 30 nëntor 1994 në lidhje me përdorimin e një dokumenti standard udhëtimi për dëbimin e shtetasve të vendeve të treta (OJ C 274, datë 19.9.1996, fq.18)

2. Vërtetuar me Instruksionin nr.553 të 19 nëntorit 2003 të zv.Ministrit të Punëve të Jashtme për dhënien e lejekealimit (*laissez-passer*) nga përfaqësitë shqiptare për kthime në Shqipëri.

3. Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit më 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me komunikimin e të dhënave personale dhe me lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (OJ L 281 më 23.11.1995, fq.31).

ANEKSI 1

Lista e përbashkët e dokumenteve, paraqitja e të cilëve konsiderohet si provë për shtetësinë (nenet 2 (1), 3 (1), 4 (1) dhe 5 (1))

- pasaporta të çdo lloji (pasaporta të shteteve, pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi, pasaporta kolektive dhe pasaporta zëvendësuese, përfshi pasaportat e fëmijëve);
- kartat e identitetit të çdo lloji (përfshi edhe kartat e përkohëshme dhe provizore);
- librezat ushtarake dhe karta identiteti ushtarake;
- librezat marinarësh dhe karta shërbimi të kapitenëve të anijeve;
- certifikata shtetësie dhe dokumente të tjera zyrtare që përmendin apo tregojnë shtetësinë.

ANEKSI 2

Lista e përbashkët e dokumenteve, paraqitja e të cilave konsiderohet si provë *prima facie* (e qartë) për shtetësinë

(nenet 2 (1), 3 (1), 4 (1) dhe 5 (1))

- fotokopje e secilit nga dokumentet e shënuara në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje;
- patenta ose fotokopje të tyre;
- certifikatat e lindjes ose fotokopjet e tyre;
- kartat e identitetit të kompanive ose fotokopje të tyre;
- dëshmi nga dëshmitarë;
- dëshmi të bëra nga personi në fjalë dhe gjuha e folur prej tij/saj, përfshi edhe përfundimet e një provimi zyrtar;
- çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë për të përcaktuar shtetësinë e personit në fjalë.

ANEKSI 3

Lista e përbashkët e dokumenteve të cilat konsiderohen si provë e kushteve për ripranim të shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

(nenet 3 (1) dhe 5 (1))

- vulat e hyrjes/daljes ose shënime të ngjashme në dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë ose prova të tjera të hyrjes/daljes (p.sh. fotografike);
- dokumente, certifikata dhe fatura të çdo lloji (p.sh. fatura hoteli, konfirmime për trajtim mjekësor ose spitalor, dokumente hyrje për në institucione publike/private, marrëveshje për marrje makinash me qira, fatura të kartave të kreditit, etj) që tregojnë qartë që personi në fjalë ka qëndruar në territorin e shtetit të kërkuar;
- bileta dhe/ose lista pasagjerësh të udhëtimeve me avion, tren, autobus apo anije, të cilat tregojnë praninë dhe itinerarin e personit në fjalë në territorin e shtetit të kërkuar;
- informacion që tregon se personi në fjalë ka përdorur shërbimet e një agjencie transporti apo udhëtarësh;
- dëshmi zyrtare të lëshuara, në veçanti, nga pjestarë të personelit të autoriteteve kufitare dhe dëshmitarë të tjerë që mund të dëshmojnë për kalimin e kufirit nga ana e personit në fjalë;
- dëshmi zyrtare të bëra nga personi në fjalë në procedura gjyqësore apo administrative.

ANEKSI 4

Lista e përbashkët e dokumenteve që konsiderohen si prova të qarta për kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

(nenet 3 (1) dhe 5 (1))

- përshkrim i vendit dhe rrethanave në të cilat personi në fjalë është kapur pas hyrjes në territorin e shtetit kërkuar, lëshuar nga autoritetet përkatëse të atij shteti;
- informacion lidhur me identitetin dhe/ose qëndrimin e një personi lëshuar nga një organizatë ndërkombëtare;
- dëshmi nga personi në fjalë;
- njoftim/konfirmim i informacionit nga pjesëtarët e familjes, shoqëruesit në udhëtim, etj.

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR LIDHJEN ME MARRËVESHJEN E ARDHËSHME TË STABILIZIMIT DHE ASOCIMIT

Palët mbajnë parasysh se më 31 janar 2003, nisën negociatat mbi lidhjen e një Marrëveshjeje Stabilizimi dhe Asociimi (MSA) ndërmjet Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Komunitetit dhe vendeve anëtare të tij, nga ana tjetër, e cila do të përfshijë gjithashtu dispozita mbi parandalimin dhe kontrollin e emigrimit të paligjshëm dhe ripranimin. Rrjedhimisht, Palët bien dakord që kjo Marrëveshje do të merret plotësisht në konsideratë në dispozitat përkatëse të MSA.”

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR NENIN 3

Palët mbajnë parasysh se detyrimi për ripranim ndaj shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi që disponojnë një vizë të vlefshme të lëshuar nga Shqipëria (neni 3 (1) (a) i kësaj Marrëveshjeje) do të zbatohet vetëm nëse viza është përdorur për të hyrë në territorin e Shqipërisë.

DEKRET
Nr.5756, datë 10.6.2008

PËR DHËNIE GRADE MADHORE

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 13 pika 5 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 7 pika 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kolonel Maksim Malaj, i jepet grada madhore Gjeneral Brigade.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5757, datë 10.6.2008

PËR DHËNIE GRADE MADHORE

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 13 pika 5 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 7 pika 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kolonel Viktor Bërdaj, i jepet grada madhore Gjeneral Brigade.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5758, datë 10.6.2008

PËR DHËNIE GRADE MADHORE

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 13 pika 5 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 7 pika 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kolonel Zyber Dushku, i jepet grada madhore Gjeneral Brigade.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET

Nr.5759, datë 10.6.2008

PËR DHËNIE GRADE MADHORE

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 13 pika 5 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 7 pika 7 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kolonel Vladimir Qiriazhi, i jepet grada madhore Gjeneral Brigade.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 11.6.2008
Doli nga shtypi më 11.6.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë